PËRMBLEDHJA E TESTEVE PËR DHËNIEN PROVIMIT TË MATURËS DHE PROVIMIT PROFESIONAL NË

# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

ispitni centar

Zavod za udžbenike i nastavna sredstva
PODGORICA

PËRMBLEDHJA E TESTEVE TË PUBLIKUARA

# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

ispitni centar

Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË

# ZBIRKA TESTOVA ZA POLAGANJE MATURSKOG I STRUČNOG ISPITA IZ

# ALBANSKOG JEZIKA

# PËRMBLEDHJE E TESTEVE PËR DHËNIEN E PROVIMIT TË MATURËS DHE PROVIMIT PROFESIONAL NË

# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI


Botuesi:

ISPITNI CENTAR, PODGORICË
ENTI I TEKSTEVE DHE I MJETEVE MËSIMORE, PODGORICË

Për botuesin:

Dr. ZHELKO JAQIMOVIQ
NEBOJSHA DRAGOVIQ

# PARATHËNIE

Të nderuar kandidatë/kandidate,

Para jush është përmbledhja e testeve të zgjidhura për Provimin e Maturës dhe Provimin Profesional në Gjuhë shqipe dhe letërsi. U hartua me qëllim që të përgatiteni sa më lehtë për Provimin e Maturës dhe Provimin Profesional. Kjo përmbledhje ju kushtohet, para së gjithash, juve për ta dhënë sa më me sukses provimin, por edhe mësimdhënësve, të cilët ju përgatisin për Provimin e Maturës dhe Provimin Profesional. Përmbledhja përmban detyra të publikuara deri tani, me të cilat kontrollohet të kuptuarit e tekstit të lexuar funksional dhe letrar, dija nga historia e letërsisë, teoria e letërsisë, semantika, zbatimi i rregullave shkencore dhe gjuhësore në shkrimin e esesë shkollore, përkatësisht tekstit funksional. Gjithashtu, përmban edhe zgjidhjet dhe skemat për vlerësimin e detyrave, eseve shkollore dhe tekstit funksional, në mënyrë që të mund të kontrolloni me çfarë suksesi e keni zgjidhur testin, përkatësisht si jeni përgjigjur në temën nga letërsia dhe në të ashtuquajturën temë e lirë ose si e keni shkruar tekstin funksional.

Do të vëreni se deri më tash nxënësit kanë pasur vetëm një test i cili ka një numër të caktuar të detyrave plotësisht të njëjta si në Provimin e Maturës ashtu edhe në Provimin Profesional. Ka qenë e paraparë të dallohet vetëm detyra e 30-të: në Provimin e Maturës është dashur të shkruhet eseja shkollore (kandidatët zgjedhin temën ose nga letërsia, ose të ashtuquajturën temë e lirë), kurse në Provimin Profesional teksti funksional (letra, lutja, ankesa, e-majli, paraqitja në konkurs...). Mirëpo, për shkak të rrethanave specifike dhe arsyeve objektive, ka ndodhur një ndryshim në strukturën e provimit, kështu që në vitin 2011 dhe 2012 të gjithë kandidatët (edhe ata që kanë dhënë Provimin e Maturës, edhe ata që kanë dhënë Provimin Profesional) kanë shkruar vetëm esenë shkollore. Dallimi në mes të Provimit të Maturës dhe Provimit Profesional ka qenë vetëm në numrin e pikëve gjatë zbatimit të rregullave shkencore gjuhësore.

Urojmë që kjo përmbledhje ta bëjë sa më të lehtë përgatitjen tuaj për Provimin e Maturës dhe Provimin Profesional.

*Luigj Berisha,*
*koordinator për Gjuhën shqipe*

# RREGULLAT PËR ZGJIDHJEN E TESTIT NË PROVIMIN E MATURËS DHE PROVIMIN PROFESIONAL

- Koha për zgjidhjen e testit të Provimit të Maturës është 150 minuta. Koha për zgjidhjen e testit të Provimit profesional është 120 minuta.
- Detyra do të vlerësohet me (0) zero pikë nëse:
    - nuk është zgjidhur saktë;
    - janë rrethuar më shumë përgjigje;
    - është rrethuar ose shkruar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë;
    - nuk është shkruar lexueshëm dhe e paqartë;
    - zgjidhja është shkruar me laps të thjeshtë.

- Teksti funksional do të vlerësohet me (0) zero pikë nëse:
    - nuk është shkruar forma e kërkuar e tekstit;
    - nuk është shkruar lexueshëm;
    - është shkruar me laps të thjeshtë;
    - është shkruar me shkronja shtypi pa theksuar shkronjën e madhe aty ku duhet të jetë;
    - nuk është shkruar në fletët e parapara për shkrimin e tekstit funksional;
    - nëse nxënësi/nxënësja nuk ka edukatë në shprehje;
    - nëse nxënësi/nxënësja vizaton, ilustron, shkruan barsoleta dhe ngjashëm;
    - nëse nxënësi/nxënësja i drejtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë vlerësuesit.

# RREGULLAT PËR SHKRIMIN E ESESË SHKOLLORE NË PROVIMIN E MATURËS DHE PROVIMIN PROFESIONAL

- Koha për zgjidhjen e testit të Provimit të Maturës është 120 minuta.
- Eseja duhet formuluar si tërësi (të ketë hyrjen, zhvillimin, përfundimin) dhe të kihet kujdes për paragrafët. Plani i esesë mund të jetë i shkruar në fletët për koncept, dhe pastaj eseja të përshkruhet me kujdes, me laps kimik ose stilolaps në fletat e parapara për shkrimin e saj.
- Duhet pasur kujdes për aspektin gjuhësor, që shkrimi të jetë i lexueshëm, fjalitë të jenë të qarta, të kuptueshme dhe të mos ketë gabime gjuhësore.
- Eseja duhet të ketë nga 250 deri në 300 fjalë. Duhet të respektohet kërkesa për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka nga 225 fjalë deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë, NUK LEXOHET FARE, kurse në 330 fjalë NDËRPRITET LEXIMI)
- Eseja do të vlerësohet me (0) pikë:
    - nëse përmbajtja nuk përputhet me temën e zgjedhur
    - nëse ka më pak se 225 fjalë (titulli nuk numërohet)
    - nëse nuk është e lexueshme
    - nëse është shkruar me laps të thjeshtë
    - nëse është shkruar me shkronja të mëdha shtypi pa theksuar shkronjën e madhe aty ku duhet
    - nëse nxënësi/nxënësja nuk ka kulturë në të shprehur
    - nëse nxënësi/nxënësja vizaton, ilustron, shkruan mahi dhe gjëra të ngjashme
    - nëse nxënësi/nxënësja drejtpërsëdrejti i drejtohet vlerësuesit

# TESTI NË PROVIMIN E MATURËS

Duke shfrytëzuar tekstin "Në tryezë emulgatorët të cilët mund të shkaktojnë karcinome – Çka janë numrat – E, përgjigju në pyetjet 1, 2, 3, 4 dhe 5.

***"Në tryezë emulgatorët të cilët mund të shkaktojnë karcinome – Çka janë numrat – "E "?***

*Mjaft produkteve ushqimore u shtohen aditivë, gjegjësisht substanca kimike natyrore dhe sintetike, me qëllim që t'u zgjatet afati i përdorimit, t'u rritet vlera ushqyese, të lehtësohet përpunimi dhe përgatitja e ushqimit, si dhe t'u përmirësohet shija, ngjyra, aroma, përbërja ose pamja e tyre. Në etiketë ku është shënuar përbërja e prodhimit, ndonjëherë mund të gjenden mjaft aditivë të shënuar me numrat – E. Këta numra kanë të bëjnë me aditivë artificialë dhe natyrorë, përdorimi i të cilëve është lejuar ose, së fundi, disa prej tyre janë ndaluar në vendet e Bashkimit Evropian. Numrat - E i kanë shumë ngjyra, konservanse, antioksidues, emulgatorë... Natyrisht rekomandimi i ekspertëve është që të hamë sa më pak ushqime të përpunuara, konservuara, gjë që është e pamundshme ta zbatojmë në tërësi këtë rekomandim. Këtu bëjnë pjesë edhe cigaret dhe pijet. Mjaft prej këtyre prodhimeve janë të rrezikshme për shëndetin. Disa prej emulgatorëve janë shkaktarë të tumoreve të ndryshme. Ata ndodhen në shveps, limuntus, bonbone gome, bonbone prej çokollate, shkopinj prej soje, senf me aromë, mish të konservuar, djathë, kërpudha në kavanoz, pudingun e vanilës, në sose të gatshme, salcë, majonezë... Disa nga këta emulgatorë shkaktojnë sëmundjen e enëve të gjakut, sëmundjen e traktit të zorrëve të barkut, sëmundjen e mëlçisë dhe veshkave, sëmundjen e lëkurës, kurse janë të dëmshëm edhe për nervat, – shpjegon pediatrja Mirjana Erakoviq.*

*Ajo thekson se rrezik i veçantë u kërcënohet fëmijëve, sepse përdorimi i këtyre artikujve e dëmton shumë organizmin në rritje dhe në zhvillim.*

*- Janë në rritje të dukshme sëmundjet e alergjisë, të lëkurës dhe sëmundjet malinje edhe në moshën e fëmijëve, ndërsa ushqimi është faktor i rëndësishëm në parandalimin e tyre, – tërheq vërejtjen mjekja Erakoviq.*

## *Vendimi është në duart tona*

*Sipas fjalëve të mjekut Predrag Shlivançanin, çdo shtet kujdeset për ushqimin e drejtë të popullatës së vet, çka nënkupton kontrollimin e eksportit dhe prodhimit të ushqimit. Ai saktëson se pengimi i paraqitjes, së aditivëve të rrezikshëm në artikuj është punë e Entit Higjienik dhe inspeksioneve të tregut, të cilat duhet ta ndalojnë importin e produkteve që përmbajnë materie të rrezikshme dhe të bëjnë teste bakteriologjike e të kontrollojnë vlerën e kalorive dhe referencat e tjera.*

*Edukimi i popullatës për përdorimin e konservanseve të dëmshme është i domosdoshëm, konsideron ai, dhe shton se qytetarët, derisa shteti të mos përkujdeset për këtë problematikë në mënyrë serioze – duhet që vetë të shikojnë se çka blejnë dhe kur t'i shohin numrat – E të rrezikshëm, të mos i blejnë ato produkte.*

Në Mal të Zi, -thotë më tej ai, -absolutisht ekzistojnë ushqimet e rregullta ekologjike sikurse janë: mazat dhe prodhimet e tjera nga veriu, patatet e bjeshkëve, djathi i Plevles i cili është "dhuratë e perëndisë" dhe duhet të kemi kujdes t'i mbrojmë ato prodhime.

## *Lexoni etiketat*

*Në raportin e klinikës për pediatri onkologjike nga Dyseldorfi, krahas regjistrit të aditivëve të parrezikshëm, është dhënë edhe lista e atyre aditivëve që janë të rrezikshëm. Si të "dyshimtë" janë cekur: E-125, 141, 150, 153, 171, 172, 173, 240, 241 dhe 447.*

*Shtime të rrezikshme kanë: E-102, 110, 120 dhe 124. Të dëmshëm për shëndetin, sepse shkaktojnë pengesa në punën e zorrëve, janë: E-220, 221, 224 dhe 232. Sëmundje të lëkurës shkaktojnë: E-230, 231, 232 dhe 233 , kurse ngacmues të nervave janë : E-311 dhe 312.*

*E-330 është theksuar si shtesa më e rrezikshme që shkakton kancer. Këtë përmbajtje e kanë, për shembull, shvepsi prej limoni, senfi, disa pije të gazuara joalkoolike, disa majoneze dhe salca, si dhe djathërat dhe kërpudhat në konserva. Ky emulgator jashtëzakonisht i rrezikshëm gjendet në shumë produkte ushqimore në shitore të Malit të Zi!*

*I njëjti rast është edhe me emulgatorin shumë helmues E-123, i cili është i ndaluar në SHBA. Edhe ai është i pranishëm në tryezat tona.*

*Është vërtetuar se veti kanceri kanë edhe E-131, 142, 210, 211, 213, 214, 215, 216, 217 dhe 239.*

*Përgatitur sipas tekstit të M.P. (Vijesti, 31. 12. 2001)*

**1. Çka janë numrat - E?**

1. substanca kimike natyrore dhe sintetike të cilat u shtohen produkteve
2. shenja për produktet ekologjike të rregullta dhe të shëndosha
3. produkte të ndaluara në vendet e Bashkimit Evropian

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.*

................................................................ ***1 pikë***

**2. A i përgjigjet nëntitulli „Vendimi është në duart tona" përmbajtjes së tekstit me të cilin ka të bëjë? Duke u bazuar në tekst, argumento qëndrimet e tua.**

_______________

_______________

_______________

***1 pikë***

**3. „...sepse përdorimi i këtyre artikujve e dëmton shumë organizmin në rritje dhe zhvillim..."**
**Për cilat sëmundje mendohet në këtë pjesë të tekstit?**

_______________

_______________

_______________

***2 pikë***

**4. A) Rretho numrin para produktit në përbërje të të cilit është elementi shumë i rrezikshëm për shëndetin dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.**

1. BISKOTAT E BLUARA PLAZMA
   *Përbërësit: miell gruri, sheqer, gjalpë, miell prej soje, yndyra e hidrogjenizuar prej bimëve, mjaltë, dekstroza, hirra në pluhur, qumësht pa mazë në pluhur, mjete për ngritjen e brumit (E503, E500), kripë, emulgator – lecitina e sojës, vitaminat (vitamina C, niacini, vitamina B6, tianini), aroma. Mund të përmbajnë gjurmë lajthie. Duhet ruajtur në vend të thatë dhe të ftohtë.*

2. SHKOPINJTË ME SUSAM
   *Përbërësit: miell gruri, susam (22%), vaj bimësh, kripë, mjete për ngritjen e brumit (E500, E503). Duhet ruajtur në vend të thatë dhe të ftohtë.*

3. BONBONET ZHELE
   *Përbërësit: sheqer, shurup amidoni, ujë, mjete për zhele, acidi i limonit (E330), aromat, ngjyrat (E102, E110, E124, E131). Duhet ruajtur në vend të thatë dhe të ftohtë.*

***1 pikë***

B. Cila është kjo përbërje? Argumento qëndrimin tënd.

**_1 pikë_**

5. **MIELLI KOKOS**

*Përbërësit: mielli kokos, konservans SO2 (E220).*

*Cilësia I. Prodhimi 2008. Alergen info: Produkti përmban SO2. Mund të përmbajë gjurmë të glutenit, susamit, kikirikut dhe pemëve me bërthamë. Duhet ruajtur në vend të thatë dhe të ftohtë.*

*Çfarë është qëllimi i ALERGEN INFO-s në tekstin e dhënë?*

1. Të informojë të interesuarit për cilësinë e produktit.
2. Të paralajmërojë personat alergjikë në përbërjen e produktit.
3. T'u shpjegojë shitësve si duhet ruajtur produkti.

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.*

**_1 pikë_**

## Lëngjet e frutave dhe nektaret

*Në ditët e verës, por edhe rëndom, marrim më së shumti lëngje përmes pijeve të ndryshme. Mirëpo, ka shumë rëndësi se çfarë pijesh marrim dhe cila është përmbajtja e tyre!*

*Si t'i dallojmë lëngjet e frutave dhe nektaret nga pijet e tjera joalkoolike ose thënë më saktë, a dimë se çka pimë kur zgjedhim lëngun e frutave apo nektarin?*

### *Lëngu i frutave*

Lëngu i frutave është produkt i përpunimit mekanik i një ose më shumë frutave të shëndosha, teknologjikisht të pjekura, të freskëta ose frutave të freskuara që nuk janë të fermentuara.

*Lëngu i frutave mund të fitohet edhe nga pemët e freskëta, me kullim, kurse mund të fitohet edhe me hollimin e lëngut të koncentruar. Kur lëngu koncentrohet, nga ai ndahen materiet aromatike.*

*Kur lëngu i koncentruar hollohet më vonë me ujë (i shtohet aq ujë sa është avulluar me koncentrim, ashtu që përsëri kthehet në përmbajtje të lëngut amë), i shtohet edhe aroma e ndarë.*

*Lëngjet përmbajnë të gjithë përbërësit e frutave, qoftë në formë të kthjellët, të përzier ose të dendur. Ai është 100% lëng natyror. Lëngut nuk i shtohet uji. Nëse i shtohet sheqer, atëherë duhet të theksohet në deklaratë dhe pako se lëngu është me sheqer. Lëngut të njëqindpërqindtë mund t'i shtohet edhe acid. Por, nuk guxohet t'i shtohet edhe sheqeri, dhe acidi, pra ose njëri, ose tjetri.*

## Nektari i lëngut

*Nektari i lëngjeve është produkt me shtesën e ujit dhe sheqerit ose të mjaltit (në sasi deri në 20 % në raport me sasinë e përgjithshme të produktit të gatshëm) lëngut të frutave, lëngut të frutave nga koncentrati, lëngut të koncentruar, të dehidruar ose lëngut të frutave në pluhur, qullit të frutave, qullit të frutave të koncentruara ose përzierjes së këtyre produkteve.*

*Natyra e përbërjes së frutave dikton përqindjen. Për shembull, nektari prej pjeshke ka 40% të frutave. Kur kjo përqindje do të ishte 50%, nektari nuk do të mund të pihej, sepse do të ishte shumë i dendur. Ose, pjesa e vishnjës është 35% për arsye se ajo është e thartë. Kur kjo pjesë do të ishte më e madhe, nektari do të ishte shumë i thartë. Për këtë arsye bëhen lëngjet 100% nga vishnja, boronica, rrushit i serezit (frëngut), sepse janë shumë të tharta. Lëngjet që kanë përmbajtjen njëqind për qind bëhen vetëm nga ajo pemë që ka raportin harmonik të sheqerit dhe acideve, ku nuk theksohen as të ëmblit e as thartira. Frutat që kanë shumë thartinë nuk mund të pihen ashtu, askush nuk do të pijë lëngun e 100% të limonit, kurse lëngun e portokallit, të mollës ose rrushit për shembull do ta pinë.*

*Lëngjet dhe nektaret nuk guxojnë të kenë konservanse dhe për këtë arsye ato trajtohen në mënyrë termike, gjegjësisht pasterizohen dhe hermetikisht mbyllen në ambalazhin që garanton sigurinë e cilësisë. Gjithashtu, nuk guxojnë të përmbajnë ngjyra artificiale dhe aroma artificiale.*

*Në lëngje mund të shtohet edhe vitamina C. Ajo, kryesisht, shtohet të mbrojë ngjyrën dhe antioksiduesin nga ndryshimi. Në deklaratë shkruan nëse është shtuar vitamina C.*

## Pija freskuese

*Gjithçka që përmban më pak nga përqindja e parashikuar e lëngut për nektar për llojin e caktuar, bën pjesë në pije freskuese. Ekzistojnë pije freskuese joalkoolike të cilat kanë 0% fruta, domethënë nuk kanë fare, kurse mund të jenë edhe në minimum 10%, gjegjësisht për citruse 6%. Kur ka ndërmjet 10% dhe përqindjes së paraparë për nektar, ato janë pije freskuese me lëng peme, të cilat te ne nuk janë gjithaq të pranishme. Pijes freskuese, qoftë të përmbajë frute ose të mos ketë fare, guxohet t'i shtohen konservansi, ngjyra dhe aroma. Konservansi është i lejuar dhe gjithmonë është i pranishëm. Ai është i domosdoshëm*

*për ta mbajtur cilësinë e produktit (pengon prishjen), sepse këto pije paketohen në ambalazh plastik që nuk mund të sigurojë mbylljen hermetike që e siguron ambalazhi në të cilin paketohen nektari dhe lëngu i frutave.*

*(përgatitur dhe marrë nga sajti*
*www:novosadski net-zdravlje i porodica)*

*Në bazë të tekstit “ **Lëngjet e frutave dhe nektaret**” përgjigju në pyetjet 6, 7, 8, 9 dhe 10.*

**6. Rretho numrin para konstatimit të saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.**

1. Nektari i frutave është lëng frutash.
2. Nektari i frutave është lëng frutash i koncentruar.
3. Nektari i frutave është produkt me përqindje të lartë të lëngut të frutave.

***1 pikë***

**7. Në bazë të tekstit të lexuar “Lëngjet e frutave dhe nektaret” dhe tekstit nga ambalazhi për lëngje, rretho numrin para produktit me përmbajtje më të lartë të frutave dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.**

1. ANANAS – nektari i kthjellët i frutave
2. ANANAS – lëngu i frutave
3. ANANAS –nektari i dendur i frutave

***1 pikë***

**8. Rretho numrin para llojit të frutave, pjesa e cilit frutë në produktin e lëngut të pemëve NUK MUND të jetë 100% dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.**

1. mollë
2. dardhë
3. portokall

Argumentoje përgjigjen.

___

___

___

***1 pikë***

**9. Lexo deklaratën e produktit e pastaj rretho numrin para deklaratës, në të cilën është përbërja e saktë e produktit, duke marrë parasysh tipin e produktit dhe llojin e frutave dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.**

1. Tipi i produktit: lëng frutash
   *Lloji i frutës: portokall*

   *Përbërja: përbërja e frutës 100%, sheqer, thartira e limonit. I pasterizuar pa shtesë të konservansit, ngjyrave artificiale dhe aromave. Tunde para përdorimit. Pas hapjes, ruaje në vend të ftohtë.*

   *Mund të përdoret deri në datën e shënuar në ambalazh.*

2. Tipi i produktit: lëng frutash
   *Lloji i frutës: portokall*

   *Përbërja: përbërja e frutës 100%, sheqer, vitamina C. I pasterizuar pa shtesë të konservansit, ngjyrave artificiale dhe aromave. Tunde para përdorimit. Pas hapjes ruaje në vend të ftohtë.*

   *Mund të përdoret deri në datën e shënuar në ambalazh.*

3. Tipi i produktit: lëng frutash
   *Lloji i frutës: portokall*

   *Përbërja: përbërja e frutës 100%, i ngjyrosur me ngjyrë artificiale. I pasterizuar pa shtesë të konservansit, ngjyrave artificiale dhe aromave. Tunde para përdorimit. Pas hapjes ruaje në vend të ftohtë.*

   *Mund të përdoret deri në datën e shënuar në ambalazh.*

........................................................................................................ ***1 pikë***

**10. Përbërësit themelorë të shvepsit biter lemon janë: uji, shurupi i fruktozës së lartë, thartira e limonit, aromat, konservanset, stabilizuesit, maksi i kinit maks. 85mg/l, ngjyra: beta karotina. Në bazë të përbërësve, shvepsi është:**

1. nektar frutash i kthjellët prej limonit,
2. pije freskuese me shije të limonit,
3. lëng pemësh prej lëngut të koncentruar të limonit.

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.*

........................................................................................................ ***1 pikë***

*Teuta dhe unë kemi vendosur që të bëjmë një ëmbëlsirë të quajtur kubet franceze. Kemi menduar se këtë do ta bëjmë shpejt dhe lehtë. Atëherë u paraqit Petriti. Ishte mjaft nervoz, i mërzitur dhe gjithçka i pengonte.*

*I pengonin petat mbi tavolinë, biskotat e bluara, arrat, rrushi i thatë... Çokollatën për zierje e hëngri. Saktësisht dy radhë. Vendosa t'ua jap këmbëve.*

*(Nga hartimi me shkrim i një nxënëseje)*

*Duke shfrytëzuar tekstin e dhënë, zgjidh detyrat 11, 12 dhe 13.*

**11. Rretho numrin para frazeologjisë që i përgjigjet fjalisë: » Ishte mjaft nervoz, i mërzitur dhe gjithçka i pengonte.« dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.**

1. Hiq dorë nga kjo punë boshe.
2. Shtirem si i pafajshëm.
3. I ka rënë sëpata në mjaltë.
4. Është ngritur në këmbë të majtë.

........................................ ***1 pikë***

**12. Shpjego domethënien e frazeologjisë " t'ua jap këmbëve".**

______________________________________

______________________________________

______________________________________

........................................ ***1 pikë***

**13. Cilit lloj të fjalëve i përkasin fjalët shpejt dhe lehtë?**

1. kallëzuesve
2. mbiemrave
3. ndajfoljeve
4.

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.*

........................................ ***1 pikë***

**14. Renditi sipas radhës historike nga numri 1 deri në 8 epokat historike në vazhdim: mesjetën, romantizmin, barokun, antikën, modernizmin, realizmin, rilindjen, klasicizmin.**

1. ______________________
2. ______________________
3. ______________________
4. ______________________
5. ______________________
6. ______________________
7. ______________________
8. ______________________

................................................................................ ***1 pikë***

**15. Rretho numrin para fjalës së shkruar drejt dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.**

1. katërqind e tridhjetenjë
2. katër qind e tridhjetëenjë
3. katërqind e tridhjetë e një

................................................................................ ***1 pikë***

Lexo tekstin dhe kryej detyrat në vazhdim.

## RRËNJA DHE DEGA

*Letërsi të e ndryshme në botë, sa i përket vendeve e shteteve, gjuhëve dhe rajoneve në të cilat janë krijuar kanë histori nga më të çuditshmet. Thuhet zakonisht se janë qendrat të cilat prodhojnë vlerat më të larta në kulturë e letërsi. Por, duke pasur parasysh ndryshimet kronologjike, kur një qendër mund të bëhet periferi dhe anasjelltas dhe në kohën aktuale kur tashmë realisht një shkrimtar mund të bëjë letërsi për çmimin Nobël edhe duke jetuar në një ishull, është relativizuar edhe më shumë pohimi se vetëm qendrat mund të krijojnë vlerat e vërteta letrare. P.sh. në qoftë se Parisi deri vonë mund të konsiderohej qendra kryesore e letërsisë, aktualisht Londra e Nju-Jorku, mund të jenë më përpara.*

*Në rrafshin shqiptar,nëse mund të thuhet se janë Tirana e Prishtina të cilat përbëjnë qendrat kulturore shqiptare,nuk do të thotë se të këtilla kanë qenë gjithnjë. Po përmendim rolin që në këtë drejtim e ka pasur Shkodra në kulturë e letërsi, deri në vitet e pasluftës së dytë Botërore. Po të mos ishin, sidomos autorët shkodranë në letërsinë shqiptare: Fishta, Camaj, Koliqi, letërsia shqiptare do të kishte një pamje tjetër, sigurisht më të zbehtë. Por, po t'i relativizojmë kufijtë politikë të vendeve shqiptare, gjeografikisht Ulqini është në mes të vendeve shqiptare. Dhe ky mes që pastaj mund të dalë se ka qenë pikërisht i destinuar që të jetë vendi ku ka nisur të bulojë për herë të parë letërsia shqipe, ka mbështetje në një fakt që tashmë është i pranuar gjerësisht nga personalitetet më të njohura të shkencës së albanologjisë.....*

*(Marrë nga "Koha javore", 9 tetor 2008)*

**16. Në cilin stil funksional është shkruar ky tekst?**

1. shkencor
2. letrar
3. publicistik
4. tjetër

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.*

........................................ ***1 pikë***

**17. Në bazë të përmbajtjes, sqaro titullin e këtij teksti.**

______________________________

______________________________

______________________________

........................................ ***1 pikë***

**18. Përcakto epokën letrare, së cilës i takojnë këta shkrimtarë.**

1. Naim Frashëri ____________________
2. O. de Balzak ____________________
3. P. P. Njegosh ____________________

........................................ ***1 pikë***

**19. Cakto çiftin e sinonimeve, antonimeve dhe homonimeve të dhëna. Në kllapa sqaro çiftin e homonimeve.**

**Sinonimet**: kurriz - ____________________

**Antonimet**: trim - ____________________

**Homonimet:** vesh *(folje)* - ____________________ *(        )*

................................................................................ ***2 pikë***

**20. Trego gjuhën dhe grupin e gjuhëve në të cilat autorët i kanë shkruar këto vepra letrare:**

1. Sh. Bodleri ”Lulet e së keqes” __________ __________
2. Dostojevski ”Krimi e ndëshkimi” __________ __________
3. E. A. Po ”Korbi” __________ __________

gjuha grupi i gjuhëve

................................................................................ ***1 pikë***

**21. Zbërthe fjalën përpunim në pjesët përbërëse të saj (rrënjë, parashtesë, prapashtesë dhe mbaresë).**

________________________________________

................................................................................ ***1 pikë***

**22. Përdori në gjuhën shqipe fjalët:**

Bravo ______________________________

Dakord ______________________________

Nacional ______________________________

Konfuz ______________________________

Konkludoj ______________________________

Vizavi ______________________________

................................................................................ ***2 pikë***

**23. Rretho veçoritë që e karakterizojnë modernizmin!**

1. Frymëzimi nga tradicionalja
2. Himnizimi i heroit lirik
3. Bukuria dhe forma

***1 pikë***

**24. Modernizmi në letërsinë shqipe fillon me:**

1. De Radën
2. Lasgush Poradecin
3. Pjetër Budin

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.*

***1 pikë***

**25. Disiplina shkencore që merret me hartimin e fjalorëve quhet:**

1. Morfologji
2. Leksikografi
3. Fonologji

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.*

***1 pikë***

**26. Gjej metaforën në vargjet e mëposhtme:**

*O flamur gjak, o flamur shkabë*

*O vend e vatër, o nën' e babë.*

*Lagur me lot, djegur me flakë.*

*Flamur i kuq. Flamur i zi!*

***1 pikë***

Lexo poezinë dhe përgjigju në pyetjen e mëposhtme.

## Pa titull

*Nata mbi qytet lëshohet*
*dhe i pari muzg*
*në heshtje mugullon*
*fushave të lulzueme të vendlindjes.*
Paqe në rudina
*e degë...Në shpirt*
*e ambla qetësi*
*si qiell i pafund mbi krye...*
*-O, heshtje e mrekullueshme e muzgut*
*ndër netët e vendit tim!*
*Qetësija jote me përkëdhelje të buta*
*Zemra të plagosuna lëmon*
*e si paqe mbulon ma të madhen dhimbje*
*si puthje dashnoreje ndër buzë...*
*E dashtuna heshtje e muzgut*
*ndër netët e vendit tim!*
*Ti je ma i miri bar*
*për shpirin tim të plagosun.*

*Esad Mekuli*

**27. Në cilin dialekt është shkruar kjo poezi?**

______________________________

**1 pikë**

**28. Në fjalinë: "Unë e dija", folja është në:**

1. kohën e tashme
2. kohën e pakryer
3. kohën e kryer të tejshkuar

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.*

**1 pikë**

**29. Shkruaj një fjali pyetëse, drejtuar vetës së dytë njëjës, nga fjalia:**
**Nuk e bëra unë.**

______________________________

______________________________

**1 pikë**

**30. Më poshtë ke dy tema për shkrimin e esesë. Rretho numrin para temës që do ta zhvillosh. Eseja duhet të përmbajë 250-300 fjalë. Hartoje atë si tërësi që duhet të ketë hyrjen, pjesën kryesore përmbajtësore dhe përfundimin. Bëj kujdes që në aspektin gjuhësor fjalia të jetë e qartë, e kuptueshme dhe të mos ketë gabime gjuhësore.**

1. ”VDEKJA E NOSITIT”

   **Këshilla për shkrimin e esesë**

   Shkruaj:

- Cili është orientimi letrar i Lasgush Poradecit?
- Mbi çka dhe si e ndërton poeti sistemin e vet poetik?
- Lasgush Poradeci e përkufizon poezinë si ndjenjë e derdhur në varg, që do të thotë se poezia është personale në shkallën e sipërme.
- Si e ndërton ligjërimin e vet poeti, respektivisht Nositi?
- Në poezi ndërtohet drama e jetës dhe e vdekjes. Sqaro?
- Poezia ndërtohet mbi figura përmes të cilave poeti ndërton konceptet. Si i gërsheton poeti ato në tekst?
- Kjo poezi është e ndërtuar mbi një simbol dhe fuqia e saj shprehëse është figura stilistike që bart dhe krijon atmosferën e dhembjes, të flijimit të klithjes për të përmbushur idealin më të madh njerëzor. Cili është ky ideal; cilat janë ato figura stilistike; cila është rima; cili është vargu që ndërton Lasgushi? Çka e karakterizon gjuhën poetike dhe stilin poetik të këtij poeti?
- Përmbylle esenë letrare duke cekur formulën apo sistemin poetik të Lasgushit!

2. “A MUNDET POSTA ELEKTRONIKE TA ZËVENDËSOJË LETRËN TRADICIONALE”

   **Këshilla për shkrimin e esesë**

   Thekso se:

- posta elektronike sot përbën bazën e komunikimit në mes njerëzve, posaçërisht të rinjve
- sa letra tradicionale shkruhen sot me dorë

- si shkruhen/si janë shkruar letrat tradicionale dhe çka është dashur / duhet të kihet parasysh gjatë shkrimit të tyre
- a mundet e-maili gjithmonë ta zëvendësojë letrën e shkruar me dorë
- cilat janë përparësitë dhe cilat janë mangësitë e njërës mënyrë të komunikimit dhe tjetrës
- a mund të paramendosh për shembull, letrën e njohur të Tatjanës dërguar Onjeginit (nga romani „Eugjen Onjegin" të A. S. Pushkinit), apo ndonjë letër tjetër të ngjashme, si e-mail
- si është qëndrimi yt për këtë dukuri (për postën elektronike)

***25 pikë***

# TESTI NË PROVIMIN PROFESIONAL

Duke shfrytëzuar tekstin "Në tryezë emulgatorët të cilët mund të shkaktojnë karcinome – Çka janë numrat – E, përgjigju në pyetjet 1, 2, 3, 4 dhe 5.

## *"Në tryezë emulgatorët të cilët mund të shkaktojnë karcinome – Çka janë numrat - E "*

*Mjaft produkteve ushqimore u shtohen aditivë, gjegjësisht substanca kimike natyrore dhe sintetike. Me qëllim që t'u zgjatet afati i përdorimit, t'u rritet vlera ushqyese, të lehtësohet përpunimi dhe përgatitja e ushqimit, si dhe t'u përmirësohet shija, ngjyra, aroma, përbërja ose pamja e tyre. Në etiketë ku është shënuar përbërja e prodhimit, ndonjëherë mund të gjenden mjaft aditivë të shënuar me numrat – E. Këta numra kanë të bëjnë me aditivë artificialë dhe natyrorë, përdorimi i të cilëve është lejuar ose, së fundi, disa prej tyre janë ndaluar në vendet e Bashkimit Evropian. Numrat - E i kanë shumë ngjyra, konservanse, antioksidues, emulgatorë... Natyrisht rekomandimi i ekspertëve është që të hamë sa më pak ushqime të përpunuara,të konservuara, gjë që është e pamundshme ta zbatojmë në tërësi këtë rekomandim. Këtu bëjnë pjesë edhe cigaret dhe pijet. Mjaft prej këtyre prodhimeve janë të rrezikshme për shëndetin. Disa prej emulgatorëve janë shkaktarë të tumoreve të ndryshme. Ata ndodhen në shveps, limuntus, bonbone gome, bonbone prej çokolate, shkopinj prej soje, senf me aromë, mish të konservuar, djathë, kërpudha në kavanoz, pudingun e vanilës, në sose të gatshme, salcë, majonezë... Disa nga këta emulgatorë shkaktojnë sëmundjen e enëve të gjakut, sëmundjen e traktit të zorrëve të barkut, sëmundjen e mëlçisë dhe veshkave, sëmundjen e lëkurës, kurse janë të dëmshëm edhe për nervat – shpjegon pediatrja Mirjana Erakoviq. Ajo thekson se rrezik i veçantë u kërcënohet fëmijëve, sepse përdorimi i këtyre artikujve e dëmton shumë organizmin në rritje dhe zhvillim.*

*- Janë në rritje të dukshme sëmundjet e alergjisë, të lëkurës dhe sëmundjet malinje edhe në moshën e fëmijëve, ndërsa ushqimi është faktor i rëndësishëm në parandalimin e tyre – tërheq vërejtjen mjekja Erakoviq.*

## *Vendimi është në duart tona*

*Sipas fjalëve të mjekut Predrag Shlivançanin, çdo shtet kujdeset për ushqimin e drejtë të popullatës së vet, çka nënkupton kontrollimin e eksportit dhe prodhimit të ushqimit. Ai saktëson se pengimi i paraqitjes, së aditivëve të rrezikshëm në artikuj është punë e Entit Higjenik dhe inspeksioneve të tregut, të cilat duhet ta ndalojnë importin e produkteve që përmbajnë materie të rrezikshme dhe të bëjnë teste bakteriologjike e të kontrollojnë vlerën e kalorive dhe referencat e tjera.*

*Edukimi i popullatës për përdorimin e konservaseve të dëmshme është i domosdoshëm, konsideron ai, dhe shton se qytetarët, derisa shteti të mos përkujdeset për këtë problematikë në mënyrë serioze – duhet që vetë të shikojnë se çka blejnë dhe kur t'i shohin numrat – E të rrezikshëm, mos t'i blejnë ato produkte.*

*Në Mal të Zi, thotë më tej ai, absolutisht ekzistojnë ushqimet e rregullta ekologjike sikurse janë: mazat dhe prodhimet e tjera nga veriu, patatet e bjeshkëve, djathi i Plevles, i cili është "dhuratë e perëndisë" dhe duhet të kemi kujdes t'i mbrojmë ato prodhime.*

## *Lexoni etiketat*

*Në raportin e klinikës së pediatrisë onkologjike nga Dyseldorfi, krahas regjistrit të aditivëve të parrezikshëm, është dhënë edhe lista e atyre aditivëve që janë të rrezikshëm. Si të "dyshimtë" janë cekur: E-125, 141, 150, 153, 171, 172, 173, 240, 241 dhe 447.*

*Shtime të rrezikshme kanë: E-102, 110, 120 dhe 124. Të dëmshëm për shëndetin, sepse shkaktojnë pengesa në punën e zorrëve, janë: E-220, 221, 224 dhe 232. Sëmundje të lëkurës shkaktojnë: E-230, 231, 232 dhe 233, kurse ngacmues të nervave janë : E-311 dhe 312.*

*E-330 është theksuar si shtesa më e rrezikshme që shkakton kancer. Këtë përmbajtje e kanë, për shembull, shvepsi prej limoni, senfi, disa pije të gazuara joalkoolike, disa majoneze dhe salca, si dhe djathërat dhe kërpudhat në konserva. Ky emulgator jashtëzakonisht i rrezikshëm gjendet në shumë produkte ushqimore në shitore të Malit të Zi!*

*I njëjti rast është edhe me emulgatorin shumë helmues E-123, i cili është i ndaluar në SHBA. Edhe ai është i pranishëm në tryezat tona.*

*Është vërtetuar se veti kanceri kanë edhe E-131, 142, 210, 211, 213, 214, 215, 216, 217 dhe 239.*

*Përgatitur sipas tekstit të M.P. (Vijesti, 31. 12. 2001)*

**1. Çka janë numrat - E?**

1. substanca kimike natyrore dhe sintetike të cilat u shtohen produkteve
2. shenja për produktet ekologjike të rregullta dhe të shëndosha
3. ™produkte të ndaluara në vendet e Bashkimit Evropian

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.*

................................................................ ***1 pikë***

**2. A i përgjigjet nëntitulli „Vendimi është në duart tona" përmbajtjes së tekstit me të cilin ka të bëjë? Duke u bazuar në tekst, argumento qëndrimet e tua.**

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

***1 pikë***

**3. „...sepse përdorimi i këtyre artikujve e dëmton shumë organizmin në rritje dhe zhvillim..."**

*Për cilat sëmundje mendohet në këtë pjesë të tekstit?*

______________________________________________

***1 pikë***

**4. A) Rretho numrin para produktit, në përbërje të të cilit është elementi shumë i rrezikshëm për shëndetin dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.**

1. BISKOTAT E BLUARA PLAZMA
   Përbërësit: miell gruri, sheqer, gjalpë, miell prej soje, yndyra e hidrogjenizuar prej bimëve, mjaltë, dekstroza, hirra në pluhur, qumësht pa mazë në pluhur, mjete për ngritjen e brumit (E503, E500), kripë, emulgator – lecitina e sojës, vitaminat (vitamina C, niacini, vitamina B6, tianini), aroma. Mund të përmbajnë gjurmë lajthie. Duhet ruajtur në vend të thatë dhe të ftohtë.
2. SHKOPINJTË ME SUSAM
   *Përbërësit: miell gruri, susam (22%), vaj bimësh, kripë, mjete për ngritjen e brumit (E500, E503). Duhet ruajtur në vend të thatë dhe të ftohtë.*
3. BONBONET ZHELE
   *Përbërësit: sheqer, shurup amidoni, ujë, mjete për zhele, acidi i limonit (E330), aromat, ngjyrat (E102, E110, E124, E131). Duhet ruajtur në vend të thatë dhe të ftohtë.*

***1 pikë***

B. Cila është kjo përbërje? Argumento qëndrimin tënd.

______________________________________________

______________________________________________

***1 pikë***

5. **MIELLI KOKOS**

*Përbërësit: mielli kokos, konservans SO2 (E220). Cilësia I. Prodhimi 2008. Alergen info: Produkti përmban SO2. Mund të përmbajë gjurmë të glutenit, susamit, kikirikut dhe pemëve me bërthamë. Duhet ruajtur në vend të thatë dhe të ftohtë.*

Çfarë është qëllimi i ALERGEN INFO-s në tekstin e dhënë?

1. Të informojë të interesuarit për cilësinë e produktit.
2. Të paralajmërojë personat alergjikë në përbërjen e produktit.
3. T'u shpjegojë shitësve si duhet ruajtur produkti.

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.*

***1 pikë***

Duke shfrytëzuar tekstin e dhënë, zgjidh detyrat 6, 7, 8, 9 dhe 10.

*Teuta dhe unë kemi vendosur që të bëjmë një ëmbëlsirë të quajtur kubet franceze. Kemi menduar se këtë do ta bëjmë shpejt dhe lehtë. Atëherë u paraqit Petriti. Ishte mjaft nervoz, i mërzitur dhe gjithçka i pengonte.*

*I pengonin petat mbi tavolinë, biskotat e bluara, arrat, rrushi i thatë... Çokollatën për zierje e hëngri. Saktësisht dy radhë. Vendosa t'ua jap këmbëve.*

*(Nga hartimi me shkrim i një nxënëseje)*

6. **Rretho numrin para frazeologjisë që i përgjigjet fjalisë: » Ishte mjaft nervoz, i mërzitur dhe gjithçka i pengonte.« dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.**
   1. Hiq dorë nga kjo punë boshe.
   2. Shtirem si i pafajshëm.
   3. I ka rënë sëpata në mjaltë.
   4. Është ngritur në këmbë të majtë.

***1 pikë***

7. **Shpjego domethënien e frazeologjisë " t'ua jap këmbëve".**

______________________________

______________________________

______________________________

***1 pikë***

**8. Cilit lloj të fjalëve i përkasin fjalët shpejt dhe lehtë?**

1. kallëzuesve
2. mbiemrave
3. ndajfoljeve

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.*

***1 pikë***

**9. Rretho numrin para fjalës së shkruar drejt dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.**

1. katërqind e tridhjetenjë
2. katër qind e tridhjetëenjë
3. katërqind e tridhjetë e një

***1 pikë***

**10. Renditi sipas radhës historike nga numri 1 deri në 8 epokat historike në vazhdim: mesjetën, romantizmin, barokun, antikën, modernizmin, realizmin, rilindjen, klasicizmin.**

1. ______________________
2. ______________________
3. ______________________
4. ______________________
5. ______________________
6. ______________________
7. ______________________
8. ______________________

***1 pikë***

**11. Në zhvillimin historik të letërsisë, Njegoshi paraqitet si përfaqësues i:**

1. klasicizmit
2. modernizmit
3. realizmit
4. romantizmit

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.*

***1 pikë***

**Lexoje tekstin në vijim dhe përgjigju pyetjeve.**

Nuse e kësaj kohe tjetër zanat s'paska,
a do marr' kalemin, që të bëj laraska,
a do zër' të shkruaj' ose do dëgjojë
një kuti të vogël që na flet me gojë,
Një kuti të vogël që mos qoft' të jet',
është' frëng i marrë, çirret e bërtet!
Me një biz në dorë bën sikur punon,
këmbën përmbi këmbë nusja e dëgjon;
dhe çudi moj motër, si e qysh duron!
Duket nga një herë zëri e lëndon,
frëngu rri qetë ose do bërtas'
nusja e humbet dhe i vete pas,
frëngu e ngrë zërin dhe sokëllin
nusja e lë perin edhe vërshëllin;
ai flet me vete, flet e flet përçartë
nusja s'ësht' në vete, bunet më e zjarrtë!

*(Fragment nga poema „Hanko halla" - Ali Asllani)*

**12. Në këtë fragment, lexuesi nusen e njeh nëpërmjet:**

1. rrëfimit të nuses
2. rrëfimit të hallës
3. rrëfimit të hallës dhe të nuses

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.*

***1 pikë***

**13. Çka kuptoni me vargun "një kuti të vogël që na flet me gojë"?**

______________________________________________

*1 pikë*

**14. Se si e dëshiron halla nusen dhe si është ajo në të vërtetë, shihet në:**

1. dallimin mes brezave
2. dallimin mes gjinive
3. dallimin mes feve

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.*

*1 pikë*

**15. Përemri "e kësaj" - është në rasën:**

______________________________________________

*1 pikë*

**16. Vargjet e lartpërmendura janë:**

1. të lira
2. të rimuara
3. të kombinuara

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.*

*1 pikë*

**17. Kur ironia quhet sarkazëm?**

1. Kur shpreh hapur përbuzjen dhe urrejtjen
2. kur shpreh hapur interesimin dhe pakënaqësinë
3. kur shpreh hapur dëshirën dhe nevojën

*Rretho numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen kaloje në fletën për përgjigje.*

*1 pikë*

**18. Cakto sinonimin e fjalës hidrik.**

______________________________________________

*1 pikë*

**19. Cilës epokë letrare i takon Aristofani:**

______________________________________________

**_1 pikë_**

**20. Veçoritë kryesore të lirikës janë:**

______________________________________________

**_1 pikë_**

**21. Si quhet personazhi kryesor i një vepre letrare që bart vetitë më të mira të njerëzve?**

______________________________________________

**_1 pikë_**

**22. Përmirëso në gjuhën standarde fjalët e mëposhtme!**

Hanë ______________________

Kthjedhet ______________________

Shetitje ______________________

Zëmër ______________________

Thëmër ______________________

**_1 pikë_**

**23. Nga rrënja e fjalës pun(ë) ndërto 5 fjalë të prejardhura.**

| Rrënja | Fjalët e prejardhura |
|---|---|
| Pun (ë) | |
| | |
| | |
| | |
| | |

**_1 pikë_**

**24. Zëvendëso fjalët e huaja me shprehjet shqipe!**

Aprovoj - ______________________

Respektoj - ______________________

Apel - ______________________

Aman - ______________________

Angazhim - ______________________

Karshi - ______________________

................................................ ***1 pikë***

**25. Shkruaj një lajm deri në 50 fjalë. Struktura e tij duhet t'u përgjigjet pyetjeve që e karakterizojnë lajmin.**

______________________

______________________

______________________

______________________

______________________

______________________

______________________

______________________

______________________

______________________

______________________

______________________

______________________

______________________

______________________

................................................ ***1 pikë***

**26. Lexo me kujdes fragmentin nga romani "Gjenerali i ushtrisë së vdekur"të Ismail Kadaresë dhe vendos shkronjat e mëdha dhe shenjat e duhura të pikësimit.**

*aji do tu çonte nënave eshtrat e bijve të tyre që gjeneralët budallenj nuk ditën të udhëhiqnin në luftë ai ishte krenar për këtë ai do të bënte çmos zoti gjeneral telefoni gjenerali u ngrit plot gjallëri më falni zotërinj me hapa të gjatë dhe madhështorë shkoi në portinerinë e hotelit*

***2 pikë***

**27. Cakto antonimin e fjalës veshur.**

***1 pikë***

**28. Cilës epokë letrare i takon Petrarka:**

***1 pikë***

**29. Zbërtheje në pjesë përbërëse fjalën atdhedashuri, duke emërtuar pjesët (morfemat) e saj.**

***2 pikë***

**30. Ndërmarrjes "Mineko" i nevojiten kamerierë. Taulant Gashi dëshiron të paraqitet për punë gjatë stinës së verës në ndërmarrjen në fjalë. Fletëparaqitjen duhet ta dërgojë me e-mail. Në bazë të të dhënave në vazhdim, shkruaje fletëparaqitjen me e-mail.**

- emri dhe mbiemri: Taulant Gashi
- e-mail: taulant.gashi@T-com.me
- e-mail: mineko@T-com.me
- përfunduar vitin IV, drejtimi kamerier
- 18 vjeç
- njohja e gjuhës angleze dhe gjuhës italiane
- 4 muaj përvojë në hotelin "Mediteran" në Ulqin

| | |
|---|---|
| From: | |
| To: | |
| Subject: | |

*10 pikë*

# TEMAT PËR HARTIMIN E ESEVE NË PROVIMIN E MATURËS DHE PROVIMIN PROFESIONAL

## ESEJA 1.
## MOTIVI I SAKRIFIKIMIT NË POEZINË "VDEKJA E NOSITIT" të Lasgush Poradecit

**Udhëzim për shkrimin e esesë**

Shkruaj:

- për periudhën e krijimtarisë së Lasgush Poradecit, kur ka lindur poezia "Vdekja e Nositit"
- për atë që flet autori në të, për motivin qendror të poezisë
- për heroin lirik që e sublimon edhe aktin e krijimit poetik
- për ndërthurjet e natyrshme të motivit të liqenit, si identifikim me shpirtin e ndjenjat e poetit
- për zjarrin e fjalës së Lasgushit që është zjarrmia e krijimit të artit të tij poetik, për rimën dhe figurat e përdorura në këtë poezi (jep shembuj konkretë)
- për vetën e rrëfimit lirik në këtë poezi dhe çfarë i jep ajo asaj
- për paralelizmin që sendërtohet nga imazhi i gjirit të hapur të Nositit-poet dhe gjirit të hapur të liqenit, për emocionet dhe idetë që përcjell ky paralelizëm te ti
- për atmosferën që mbizotëron në këtë poezi, arsyeto përgjigjen tënde

## ESEJA 2.
## „PLAKU DHE DETI"- ERNEST HEMINGUEJ

**Udhëzim për shkrimin e esesë:**

Shkruaj:

- Cilës letërsi i përket vepra letrare "Plaku dhe deti"?
- Për autorin e veprës si njërin nga shkrimtarët më në zë amerikanë të shekullit të kaluar e përfaqësues kryesor të "brezit të humbur".
- Për çmimin që ka marrë për krijimtari që kulmoi me këtë kryevepër.
- Në cilin lloj letrar e klasifikojnë këtë vepër?

- Për vendin e shtjellimit të ngjarjes.
- Për psikologjinë e plakut Santiago.
- Për teknikën shkrimore me të cilën është shkruar vepra.
- Për narratorin e veprës.
- Për temën e veprës.
- Për raportin e djaloshit Manolin me plakun Santiago, çfarë sheh ai te plaku?
- Për personazhet e tjera.
- Për idetë dhe stilin e përdorur.
- Për simbolikën e peshkaqenëve.
- Për gjuhën e veprës.
- Si e sheh ti porosinë kryesore të veprës?
- Për përshtypjet tua personale për këtë vepër

## ESEJA 3.
## „HISTORIA E SKËNDERBEUT“- MARIN BARLETI

Udhëzim për shkrimin e esesë:

Shkruaj për:

- Epokën letrare së cilës i takon "Historia e Skënderbeut" e Marin Barletit.
- Burimin që paraqet kjo vepër për jetën e heroit tonë kombëtar.
- Idetë e Barletit në "Historinë e Skënderbeut".
- Çështjen e lirisë dhe të drejtës që mbron populli shqiptar dhe Skënderbeu.
- Zotësinë oratorike të Skënderbeut.
- Trimërinë e Skënderbeut.
- Strategjinë ushtarake të Skënderbeut.
- Narracionin e pasur (përshkrimet) në veprën "Historia e Skënderbeut".
- Gjuhën në të cilën është shkruar vepra dhe arsyet përse e shkroi në atë gjuhë.
- Stilin dhe figurat letrare në vepër.
- Rrethanat historike e letrare të realizimit të veprës së Barletit "Historia e Skënderbeut".
- Konceptin humanist për historinë që ndihet në vepër dhe mesazhin e saj.

# ESEJA 4.
# ANALIZA E VEPRËS „DUKE PRITUR GODONË“ TË SAMUEL BEKETIT

**Udhëzim për shkrimin e esesë:**

1. Thekso:
    - cilit lloj të dramës i përket vepra ”Duke pritur Godonë” dhe shkruaj të paktën një autor tjetër të këtij lloji të dramës (përveç Beketit)
    - karakteristikat e këtij lloji të dramës
2. Trego për:
    - strukturën kompozicionale të dramës (sa akte ka, dallimet dhe ngjashmëritë në strukturën e akteve)
    - sjelljen e Vladimirit dhe Estragonit në skenë
    - sjelljen e Pocos dhe Likit dhe për rolin e tyre në strukturën e dramës
    - paraqitjen e djaloshit dhe porosinë që sjell nga Godoja
3. Trego për:
    - gjuhën dhe mënyrën si flasin heronjtë
    - shtresën reale dhe metafizike të dramës
4. Sqaro:
    - titullin e veprës
    - porosinë e dramës së Beketit

# ESEJA 5.
# „GJENERALI I USHTRISË SË VDEKUR“- ISMAIL KADARE

**Udhëzim për shkrimin e esesë:**

Thekso:

- Epokën letrare së cilës i takon “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” i Ismail Kadaresë.
- Idetë e Kadaresë në vepër.
- Sintagmën e ushtrisë së vdekur.
- Simbolizimin e ushtrisë së vdekur.
- Fabulën e veprës në lidhshmëri me baladën shqiptare.
- Portretin e shqiptarit human dhe fisnik.
- Rolin e priftit dhe të gjeneralit.

- Ushtrinë e vdekur e të paketuar në thasë najloni.
- Ndëshkimin moral të gjeneralit.
- Dasmën shqiptare, kulmin dhe thyerjen e moralit të gjeneralit.
- Plakën Nicë dhe lidhshmërinë me Kolonelin Z. (i gjallë dhe i vdekur).
- Rrethanat historike të ngjarjes.
- Idenë e veprës ndaj pushtuesve.
- Gjuhën, figurat, stilin dhe teknikat e tjera të veprës

## ESEJA 6.
## TEMA E MARTESËS NË KOMEDINË „KATËRMBËDHJETË VJEÇ DHËNDËR"-A. Z. ÇAJUPI

**Udhëzim për shkrimin e esesë:**

Shkruaj:

- Për tiparet në bazë të të cilave veprën "Katërmbëdhjetë vjeç dhëndër" e vendos në gjininë/llojin/zhanrin letrar përkatës.
- Sa e pasur ishte letërsia shqipe me këtë lloj letrar, në kohën kur e shkroi autori këtë vepër?
- Për temën kryesore të veprës.
- Për teknikën shkrimore (formacionin stilistik) që e karakterizon veprën.
- Për psikologjinë e kryepersonazheve, Tanës dhe Vangjelit.
- Për pozitën e gruas në shoqëri dhe për zakonet e prapambetura që rëndonin mbi shoqërinë shqiptare të asaj kohe dhe e pengonin avancimin e saj?
- Për pamjet që të kanë lënë mbresat më të forta dhe për cilat arsye?
- Për raportet e veprës me poezinë popullore dhe mendësinë e shoqërisë shqiptare të asaj kohe.
- Për atmosferën që mbizotëron në vepër.

**(Fragmente nga vepra "Katërmbëdhjetë vjeç dhëndër")**

**Pamje e parë: burrë e grua**

**Tana** : Ti pse s'e do Marigonë?
Ajo nuse bën për mua.
**Vangjeli** : Po ësht' e madhe, moj grua.
Njëzet vjeçe!...

**Tana** : Kaq e dua,
nukë marr nuse për sisë,
po për punët e shtëpisë;
të dijë të ngasë qetë,
se nukë mund t'i ngas vetë,
të na bëjë dru nga mali.
**Vangjeli** : Mirë ti, po ç'thotë djali?
Gjini me të do të rrojë.
**Tana** : Doemos që do të dojë!
Pse kuvëndon kshtu, mor burrë?
Pyeten fërnija kurrë?
Ta martojm' ashtu më rruash.
**Vangjeli**: Moj grua, bën si të duash
dhe më qafë t›i kesh vetë!
**Tana**: Em këtu, em n'at jetë!. . .
Nesër do t'vete të bluaj,
të shëtunë të gatuaj,
të diel të bëjmë dasmë,
gjithë miqtë t'i gërshasmë (Qan).
**Vangjeli**: Tani pse qa?
**Tana**: Qaj nga gazi,
më shpëtove nga marazi.
Tani do të bënem vjerrë!
**Vangjeli**: Shuaj dritën dhe shko bjerë.
(Të dy bien të flënë në shtrat. Perdja mbyllet.)
**Pamja e katërt:**
**Tana** (tek i biri): Rri me nusen, djalë,
dhe foli dy fjalë,
të mos ketë frikë.
**Dhëndërri** (thotë s'ëmësë) :
Ngreu mëm' e ikë.
(Tana ikën.)
V.
(Dhëndërri me nusenë mbeten vetëm)
**Dhëndërri**: Lozëm ndonjë lodër?
Të dua si motër.
**Nusja**: Ç'motër më ke mua,
o lum' e përrua?
Ti më more grua.
**Dhëndërri**: Pse u zemërove

dhe u hidhërove?
Kur s'lot ndonjë lodër,
s'të dua si motër,
të dua si mëmë!
Po hajde të flemë,
se më mori gjumi.

**Nusja**: Fli të marrtë lumi!
(Funt)

## ESEJA 7.
## Reklama – arsyeja për të (mos) menduar

**Udhëzim për shkrimin e esesë**

Thekso:

- që afarizmi bashkëkohor bazohet në reklamë
- çka reklamohet dhe si reklamohet
- a i përcjell reklamat në mënyrë mekanike apo mendon për to
- me ç' gjë një reklamë mund ta tërheqë vëmendjen tënde – me pjesën e saj pamore, muzikore apo verbale (shkruaj shembullin)
- rëndësinë e origjinalitetit gjatë shfaqjes së reklamës
- a i imponohet me forcë reklama njeriut bashkëkohor
- si reagojnë në këtë dukuri njerëzit që njeh ti dhe bashkëmoshatarët e tu
- cili është qëndrimi yt për këtë

## ESEJA 8.
## GRAFITET – VEPËR ARTISTIKE APO VANDALIZËM

**Udhëzim për shkrimin e esesë:**

Shkruaj:

- Për autorët e grafiteve (mbishkrimeve në faqet e mureve) disa i konsiderojnë artistë, kurse të tjerët vandalë. Jep mendimin dhe sqarimin tënd për këtë çështje.
- Për çka bëjnë fjalë më së shumti këto mbishkrime?
- Mbi cilat sipërfaqe janë të shkruara më shpesh grafitet?
- A flitet gjithmonë për porosi thelbësore, shaka, aforizma të shpeshtë apo ka edhe të tjera porosi? Sqaro mendimin tënd.

- A janë mbishkrimet mënyrë e vetme që të shprehet mospajtimi me ndonjë qëndrim. Fol për problemin ose shprehe qëndrimin tënd.
- Sa dhe si flasin mbishkrimet për autorët anonimë të tyre?
- A i njeh në ndonjë mbishkrim qëndrimet e tua? Argumento përgjigjen.
- A ndien zemërim ndonjëherë nga porositë e pahijshme që sjellin ato? Argumento përgjigjen.
- Jepe në formë të përfundimit, qëndrimin tënd për këtë dukuri.

## ESEJA 9.
## KOSTUMI (NUK) E ZBULON KARAKTERIN E NJERIUT

**Udhëzim për shkrimin e esesë:**

Shkruaj për:

- Mënyrën e veshjes së bashkëmoshatarëve të tu, si dhe për argumentet për një veshje të tillë dhe kundër saj.
- Pse vishen në mënyrë të tillë - jep mendimin tënd (p.sh. ndikimi i mjedisit, mediave – TV-së, internetit, shtypit)?
- Profesionet që kërkojnë uniformën; jep argumente për domosdoshmërinë e veshjes së uniformuar në ndonjë profesion.
- Atë nëse është e nevojshme që nxënësit të veshin uniformën; jep argumente për dhe kundër.
- Veshjen ose kombinimin e veshjes që nuk do ta veshje kurrë dhe përse.
- Atë se stili i veshjes është shprehje e personalitetit - mund ta theksojë kreativitetin e dikujt, por edhe mungesën e shijes në të veshur.
- Atë, nëse në bazë të veshjes mund të nxirren konkluzione për karakterin e njeriut. Argumento përgjigjen.
- Atë se sa mënyra e veshjes u nënshtrohet rregullave.

## ESEJA 10.
## BUZËQESHJA, DASHURIA DHE TOLERANCA - ARMË E NJERIUT BASHKËKOHOR

**Udhëzim për shkrimin e esesë:**

- Disa njerëz e shohin botën në mënyrë optimiste, disa të tjerë në mënyrë pesimiste. Jepe mendimin tënd dhe argumentoje atë.
- Argumento qëndrimin tënd, nëse mendimet e kundërta duhet të sjellin te konfliktet.

- Sqaro fjalët BUZËQESHJE, DASHURI, TOLERANCË dhe jepe situatën kur drejtohet buzëqeshja, tregohet dashuria dhe toleranca.
- Jepe mendimin për fjalinë: "Njerëzit nuk janë të uritur vetëm për bukë, por edhe për dashuri dhe kujdes".
- Në formë të përfundimit, argumento qëndrimin se buzëqeshja, dashuria dhe toleranca janë arma më e fuqishme e njeriut bashkëkohor.

## ESEJA 11.
## "KULTURA E LEXIMIT DIKUR DHE SOT"

**Udhëzim për shkrimin e esesë:**

- Si e shikon momentin e tashëm të kulturës së leximit? Jep argumente për qëndrimin tënd.
- Çka ke dëshirë të lexosh dhe pse?
- Çfarë rëndësie kishte libri në të kaluarën dhe çfarë ka sot?
- Sqaro përparësitë e mediave vizuale në raport me librin ose përparësitë e librit në raport me mediat vizuale. Krahaso ndikimin e mediave vizuale me ndikimin e veprave letrare tek bashkëmoshatarët e tu. Argumento qëndrimin tënd.
- A do ta lexosh më me ëndje librin ose do ta shikosh filmin që është xhiruar sipas atij libri apo do të informohesh përmes internetit për përmbajtjen e atij libri? Arsyeto qëndrimin tënd.
- Sqaro qëndrimin tënd, nëse në opinionin lexues dhe shijen e tij ka ndikim më të madh cilësia e veprës letrare apo marketingu. Jep shembullin e veprës letrare me të cilin do ta plotësosh qëndrimin tënd.
- Jep qëndrimin për përpjekjet në disa vende që libri t'i afrohet opinionit të gjerë dhe jep të paktën një propozim çka duhet bërë që të përparohet kultura e leximit (p.sh. në Argjentinë, saktësisht në Buenos Aires, ekzistojnë libraritë-kafene në të cilat mund të lexohet libri...).

## ESEJA 12.
## VULLNETARIZMI - PËRSOSJE PROFESIONALE APO KOHË E HUMBUR

**Udhëzime për shkrimin e esesë:**

- Shprehe qëndrimin tënd për vlerësimin se në zgjedhjen e profesionit ndikon njeriu, por edhe rrethanat.

- Cilën punë do të dëshiroje ta bësh? Përshkruaje atë punë dhe argumentoje zgjedhjen tënde.
- Vullnetarizmi është mbi baza vullnetare, punë pa pagesë. A thua bashkëmoshatarët e tu mendojnë se kjo lloj pune është e dobishme për ta? Argumentoje dhe sqaroje qëndrimin tënd.
- Sipas teje, cilat janë përparësitë dhe cilat mangësitë e punës vullnetare?
- A do të pranoje më me kënaqësi që, gjatë verës, të punosh vullnetarisht punën që e do apo punën që nuk e ke për zemër, por për të cilën do të fitosh para? Argumentoje përcaktimin tënd.
- Disa pohojnë se vullnetarizmi është përsosje profesionale, kurse të tjerët se ai është vetëm një humbje kohe. Përcaktoju për njërën thënie dhe sill argumente për ta sqaruar pretendimin tënd.

***45 pikë***

# ZGJIDHJA E TESTIT NË PROVIMIN E MATURËS

**DETYRA 1. - 1 pikë**

1. substancat kimike natyrore dhe sintetike të cilat u shtohen produkteve

**DETYRA 2.** - Nxënësi fiton **1 pikë,** nëse ka shkruar, perifrazuar ose përshkruar fjalinë nga teksti me të cilën do të argumentojë qëndrimin e tij. Për shembull:

- Po, sepse mjeku Shlivançanin thotë se qytetarët duhet të kenë kujdes se çka blejnë dhe t'u shmangen produkteve me numrat e rrezikshëm E.
- Po. Në tekst thuhet: »Edukimi i popullatës për përdorimin e ruajtësve (konservansëve) të dëmshëm është i domosdoshëm, konsideron ai, dhe shton që qytetarët, derisa të mos përkujdeset në mënyrë serioze shteti për këtë problem, duhet që vetë të shikojnë se çfarë blejnë dhe kur t'i shikojnë numrat e rrezikshëm E, ta bojkotojnë atë produkt«.
- Përgjigjet, sepse qytetarët duhet të kenë kujdes për aditivët e rrezikshëm dhe ruajtësit ( konservanset). (dhe përgjigje të ngjashme)

**DETYRA 3.** - Nxënësi fiton **2 pikë,** nëse dallon që në këtë pjesë të tekstit flitet sesi përdorimi i artikujve të këtillë dëmton posaçërisht fëmijët. Për shembull:

- Artikujt në të cilët ka numra të rrezikshëm E te fëmijët shkaktojnë sëmundje alergjike, të lëkurës dhe sëmundje malinje.
- Në sëmundjet alergjike, të lëkurës dhe sëmundjet malinje në moshën e fëmijëve.
- Substancat e rrezikshme në disa artikuj posaçërisht janë të dëmshme për shëndetin e fëmijëve dhe shkaktojnë alergji, tumore të rrezikshme, sëmundje të lëkurës.
- Alergji, sëmundje të lëkurës dhe sëmundje malinje. (dhe përgjigje të ngjashme)

**Nx**ënësi merr **1 pikë,** nëse e kupton se emulgatorët shkaktojnë sëmundje, por nuk dallon se në këtë pjesë të tekstit bëhet fjalë për fëmijë.

- Tumoret e këqija, sëmundjet e enëve të gjakut, sëmundjet e traktit të zorrëve të lukthit, sëmundjet e mëlçisë dhe veshkave, sëmundjet e nervave.
- “Disa nga këta emulgatorë shkaktojnë sëmundjen e enëve të gjakut, sëmundjet e traktit të zorrëve të lukthit, sëmundja e mëlçisë dhe veshkave, sëmundjeve të lëkurës, kurse janë të dëmshëm edhe për nervat.” (dhe përgjigje të ngjashme)

**DETYRA 4.**

**Nxën**ësi merr **1 pikë** nëse:

- rrethon numrin 3 dhe shpjegon se përbërësi i rrezikshëm është thartira e limonit ose E-330, sepse është emulgatori më i rrezikshëm që shkakton kancer.
- nuk ka rrethuar asnjë numër, por dallon se përbërësi i rrezikshëm është E-330, sepse shkakton kancer.
- ka rrethuar numrin 1 ose 2 (sipas të gjitha gjasave gabimisht), por dallon saktë emulgatorin e rrezikshëm-E-131 dhe argumenton saktë (shkakton kancerin). (dhe përgjigje të ngjashme)

**Vërejtje: pranohet edhe nëse nxënësi veçon ngjyrën dhe E-130 dhe shpjegon se ka veçori kancerogjene.**

**Nxën**ësi merr **0 pikë** nëse:

- Rrethon saktë numrin 3, por veçon përbërësin e gabuar dhe emulgatorin. P.sh. shurupin e amidonit dhe E-102, sepse është i rrezikshëm.
- Nxënësi rrethon saktë numrin 3, por nuk jep sqarim.
- Nxënësi rrethon gabimisht numrin dhe sqaron gabimisht. P.sh. rrethon numrin 1 dhe veçon emulgatorin – lecitina e sojës.

**DETYRA 5.- 1 pikë**

**2. Të paralajmërojë personat alergjikë në përbërjen e produktit.**

**DETYRA 6.- 1 pikë**

**3. Nektari i frutave është produkt me përqindje të lartë të lëngut të frutave.**

**DETYRA 7.- 1 pikë**

**2. ANANAS - lëngu i frutave**

**DETYRA 8.**

**Nx**ënësi merr **1 pikë** nëse:

- rrethon numrin 2 dhe shpjegon se pjesa e dardhës në lëngun e frutës nuk mund të jetë 100%, sepse lëngu do të ishte shumë i dendur.
- Nxënësi nuk ka rrethuar asnjë numër, por dallon që pjesa e dardhës nuk mund të jetë 100% në lëngun e frutës, sepse nuk do të mund të pihej për shkak të dendurisë.
- Nxënësi ka rrethuar numrin 1 ose 2 (sipas të gjitha gjasave gabimisht), por saktësisht dallon dardhën dhe shpjegon se pjesëmarrja e saj në lëngun e pemës nuk mund të jetë 100 për qind, sepse lëngu do të ishte tepër i dendur dhe nuk do të mund të pihej. (dhe përgjigje të ngjashme)

Nxënësi merr **0 pikë** nëse:

- rrethon saktë numrin 2, por jep shpjegim të gabueshëm, p.sh. për të qenë lëngu tepër i ëmbël ose tepër i thartë dhe ngjashëm.
- rrethon saktë numrin 2, por nuk jep ndonjë shpjegim.
- rrethon gabimisht numrin dhe jep shpjegim të gabueshëm. P.sh. rrethon numrin 1 dhe shpjegon për të qenë lëngu tepër i thartë.

  (dhe përgjigje të ngjashme)

**DETYRA 9.- 1 pikë**

**2. Tipi i produktit: lëng frutash**

*Lloji i frutës: portokall*

*Përbërja: përbërja e frutës 100%, sheqer, vitamina C. I pasterizuar pa shtesë të konservansit, ngjyrave artificiale dhe aromave. Tunde para përdorimit. Pas hapjes, ruaje në vend të ftohtë.*

*Mund të përdoret deri në datën e shënuar në ambalazh.*

**DETYRA 10.- 1 pikë**

**2. Pije freskuese me shije limoni**

**DETYRA 11.- 1 pikë**

**4. Është ngritur në këmbën e majtë.**

**DETYRA 12.**

**Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan:**

- Të ik.
- Vendosa të shkoj.
- Iki pa krye (dhe përgjigje të ngjashme)

**DETYRA 13.- 1 pikë**

**1. Ndajfoljeve**

**DETYRA 14.**

Nxënësi merr **1 pikë,** nëse i ka renditur saktë të gjitha epokat letrare:

1. **antika**
2. **mesjeta**
3. **rilindja**
4. **baroku**

5. **klasicizmi**
6. **romantizmi**
7. **realizmi**
8. **modernizmi**

**DETYRA 15.- 1 pikë**

3. katërqind e tridhjetë e një

**DETYRA 16. - 1 pikë**

3. publicistik

**DETYRA 17.**

Nxënësi merr **1 pikë** nëse:

Jep përgjigjen në përputhje me atë se çka trajton artikulli.

**DETYRA 18.**

Nxënësi merr **1 pikë** nëse:

Shkruan epokat letrare të cilave u takojnë shkrimtarët: Naimi-romantizmit; Balzaku-realizmit; Njegoshi-romantizmit.

**DETYRA 19.**

Nxënësi merr **1 pikë,** nëse:

Ka plotësuar të gjitha kërkesat.

Sinonimi: kurriz-shpinë;

Antonimi: trim-frikacak;

Homonimi: vesh(folje)-vesh...

**DETYRA 20.**

Nxënësi merr **2 pikë,** nëse:

Ka shkruar: Sh. Bodleri «Lulet e së keqes« /gj. frënge; grupi i gj. romane

F. Dostojevski «Krimi e ndëshkimi« /gj.ruse; gr. i gjuhëve sllave

E. A. Po «Korbi« /gj. angleze; grupi i gjuhëve gjermanike

Nxënësi merr **1 pikë,** nëse ka dhënë përgjigjen pjesërisht të saktë: dy kërkesa të plotësuara

**DETYRA 21.**

Nxënësi merr **1 pikë** nëse:

Ka zbërthyer fjalën: (për+pun(ë)+im)

Parashtesa+rrënja+prapashtesa

**DETYRA 22.**

Nxënësi merr **2 pikë,** nëse:

Ka plotësuar të gjitha kërkesat.

Bravo-të lumtë; dakord-në rregull(pajtohem); nacional-kombëtar; konfuz-huti, ngatërrim, pështjellim; konkludoj-nxjerr përfundimin,përfundoj; vizavi-përballë.

Përgjigjja pjesërisht e saktë **1 pikë**, nxënësit i mungojnë dy fjalë në gjuhën shqipe

**DETYRA 23.- 1 pikë**

3. Bukuria dhe forma

**DETYRA 24.- 1 pikë**

2. Lasgush Poradecin

**DETYRA 25.- 1 pikë**

2. Leksikografi

**DETYRA 26.**

Nxënësi merr **1 pikë** nëse:

Ka nënvizuar ose shkruar mbi vija metaforën në vargjet:

*O flamur gjak, <u>o flamur shkabë</u>*

*Lagur me lot, <u>djegur me flakë</u>.*

**DETYRA** 27.

Nxënësi merr **1 pikë,** nëse:

Ka shkruar se poezia e dhënë është shkruar në dialektin e Jugut (toskë)

**DETYRA 28.- 1 pikë**

2. Kohën e pakryer

## DETYRA 29.

Nxënësi merr **1 pikë,** nëse ka shkruar fjalinë pyetëse, drejtuar vetës së dytë njëjës: A nuk e bëre punën?; Nuk e bëre punën? Pse nuk e bëre punën?

Nëse përdor vetën e dytë njëjës me fjalën mohuese nuk, atëherë të pranohet: A nuk e bëre ti? ; Nuk e bëre ti?

## DETYRA 30.

### 1. "VDEKJA E NOSITIT"- L. PORADECI

### Përmbajtja

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 1.** | Nxënësi (ja) përkufizon:<br>1. orientimin letrar të poetit (1 pikë)<br>2. funksionin e figurës së Nositit në poezi (1 pikë)<br>3. llojin e poezisë (1 pikë)<br>**Gjithsej 3 pikë** |
| **Kërkesa 2.** | Nxënësi /ja tregon për:<br>sistemin poetik të poetit (1 pikë)<br>**Gjithsej 1 pikë** |
| **Kërkesa 3.** | Nxënësi(ja) tregon për:<br>1. mënyrën se si e ndërton poeti raportin midis jetës dhe vdekjes (1 pikë), poezinë e cila ndërtohet mbi figurën (1 pikë), mbi figurë ndërtohen konceptet e fuqishme jetësore (1 pikë)<br>2. klithjen që e gjejmë në poezi e që përmbush idealin e poetit (1 pikë), rëndësinë e dominimit të temës së Nositit (1 pikë), motivet e ndryshme në poezi (1 pikë)<br>3. funksionin e vargjeve "Me zjarr ju flas..., me zjarr" (1 pikë), porosinë e poetit (1 pikë), figurat stilistike dhe funksionin e tyre në poezi (1 pikë)<br>**Gjithsej 9 pikë** |
| **Kërkesa 4.** | Nxënësi (ja) tregon për:<br>rimën, ritmin dhe vargun e poezisë (1 pikë)<br>**Gjithsej 1 pikë** |
| **Kërkesa 5.** | Nxënësi /ja:<br>jep formulën bindëse për veçantinë krijuese të Lasgushit (1 pikë)<br>**Gjithsej 1 pikë** |

## Gjuha dhe forma e tekstit

| Leksiku | Drejtshkrimi | Lidhshmëria | Struktura ndërtimore e tekstit |
|---|---|---|---|
| • Vlerësohet origjinaliteti i shprehjes gjatë hartimit të esesë, pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, me gabime minimale.<br>**Gjithsej 2 pikë** | • Vlerësohet respektimi i normave gramatikore, përfundimi i drejtë i mendimeve në fjali, radhitja e saktë e fjalëve në fjali, me gabime minimale<br>**2 pikë**<br>• respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe Përdorimi me vend i shenjave të pikësimit.<br>**2 pikë**<br>**Gjithsej 4 pikë** | • lidhja logjike e paragrafëve të esesë<br>**Gjithsej 2 pikë** | • lidhja midis pjesëve të esesë, duke pasur për bazë zhvillimin logjik të tyre, por duke qartësuar edhe ndarjen midis pjesëve: hyrjes, përmbajtjes dhe përfundimit.<br>**Gjithsej 2 pikë** |
| • përsëritja e fjalëve dhe e shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta<br>**1 pikë** | • respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. të konstruksionit lidhur me, si për të, përdorimi i parafjalës për ...)<br>**1 pikë**<br>• respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të vogla (p.sh. përdorimi i shenjave të pikësimit dhe drejtshkrimit, ndarja e fjalëve në fund të rreshtit, shkrimi i gabuar i fjalëve të huaja...)<br>**Gjithsej 2 pikë** | • lidhja e mirë në nivel të tekstit me palidhshmëri të përkohshme në shkallë të paragrafëve<br>**1 pikë** | • bën ndarjen e qartë të hyrjes, shtjellimit dhe përfundimit, por nuk ndan paragrafët brenda shtjellimit.<br>**1pikë** |

## 2. ”A MUNDET POSTA ELEKTRONIKE TA ZËVENDËSOJË LETRËN TRADICIONALE”

### Përmbajtja – 15 pikë

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 1.** | Nxënësi/ja tregon që:<br>• të rinjtë gjithnjë e më shumë komunikojnë me e-maile (1 pikë), dhe për atë se posta elektronike e zëvendëson letrën tradicionale edhe në korrespondencën e punës (1 pikë)<br>**Gjithsej 2 pikë** |
| **Kërkesa 2.** | Nxënësi(ja):<br>• tregon se sot shkruhen shumë pak letra tradicionale (1 pikë)<br>• shpjegon se sot letrat tradicionale shkruhen p.sh. kur autori i letrës do t'i shprehë nderim të madh dikujt, ose nipi apo mbesa ta gëzojë gjyshen që nuk di të punojë në kompjuter, apo dikush që në shkrimin e letrës sheh romantizëm ose ndonjë argument të ngjashëm (1 pikë)<br>**Gjithsej 2 pikë** |
| **Kërkesa 3.** | Nxënësi/ja tregon se:<br>• letrat tradicionale janë shkruar me kujdes dhe dashuri të madhe (1 pikë)<br>• është pasur kujdes për bukurinë e shkrimit<br>(1 pikë), doreshkrimin e lexueshëm (1 pikë), për rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore (1 pikë)<br>**Gjithsej 4 pikë** |
| **Kërkesa 4.** | Nxënësi(ja) tregon se:<br>e-maili nuk mundet gjithmonë ta zëvendësojë letrën tradicionale dhe jep argumente për këtë, p.sh. dëshira që ta befasojmë ndonjë person të dashur, sepse duhet shumë më tepër kujdes dhe përpjekje për shkrimin e letrës me dorë për shkak të madhësisë dhe formës së shkronjave dhe ngjashëm (1 pikë)<br>**Gjithsej 1 pikë** |

<table>
<tr><td>Kërkesa 5.</td><td>Nxënësi tregon për përparësitë e e-mailit dhe letrës tradicionale:<br>• e-maili i kontribuon shpejtësisë, falen gabimet e shkronjave, shkronjat janë të njëjtës madhësi, vetëm nëse nuk dëshironi të ashtuquajturin fontin e ndryshëm, mund t'i errësoni shkronjat që të theksoni diçka, mund të bashkëngjisni ndonjë dokument (ataçment) dhe në të të dërgoni p.sh. fotografitë apo ngjashëm (1 pikë)<br>• Letra tradicionale mundëson që të shprehni dashuri dhe kujdes, sepse letra mund të jetë edhe me aromë, që në zarf të vendosni ndonjë lule, tërfilin me katër fletë të punuar enkas për atë çështje, para nëse dëshironi të uroni ditëlindjen ose t'i ndihmoni dikujt apo ngjashëm (1 pikë)<br>Nxënësi tregon në mangësitë e e-mailit dhe letrës tradicionale:<br>• nuk ruan sekretet, sepse hakerët kërcënojnë nga të gjitha anët, mund të harrohet në shpejtësi ataçmenti edhe pse autori ka dashur që ta dërgojë dhe ngjashëm (1 pikë)<br>• mund të udhëtojë gjatë dhe madje të humbë, dhe ta mësoni këtë vonë ose mos ta mësoni fare, ose gabimet e shkronjave, ato gramatikore dhe drejtshkrimore nuk mund të arsyetohen me gabim në të shtypur, por ato konsiderohen si analfabetizëm (1 pikë)<br>Gjithsej 4 pikë</td></tr>
<tr><td>Kërkesa 6.</td><td>Nxënësi paraqet qëndrimin e tij (PO ose JO) dhe e argumenton atë<br>Gjithsej 1 pikë</td></tr>
<tr><td>Kërkesa 7.</td><td>Nxënësi paraqet qëndrimin e tij për e-mailin<br>Gjithsej 1 pikë</td></tr>
</table>

## Gjuha dhe forma e tekstit -10 pikë

| Leksiku | Drejtshkrimi | Lidhshmëria | Struktura ndërtimore e tekstit |
|---|---|---|---|
| • Vlerësohet origjinaliteti i shprehjes gjatë hartimit të esesë, pasuria e gjuhës, figuracioni, shprehja e qartë dhe e saktë, me gabime minimale.<br>**Gjithsej 2 pikë** | • Vlerësohet respektimi i normave gramatikore, përfundimi i drejtë i mendimeve në fjali, radhitja e saktë e fjalëve në fjali, me gabime minimale<br>**2 pikë**<br>• respektimi i normës drejtshkrimore (shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe. Përdorimi me vend i shenjave të pikësimit.<br>**2 pikë**<br>**Gjithsej 4 pikë** | • lidhja logjike e paragrafëve të esesë<br>**Gjithsej 2 pikë** | • lidhja midis pjesëve të esesë, duke pasur për bazë zhvillimin logjik të tyre, por duke qartësuar edhe ndarjen midis pjesëve: hyrjes, përmbajtjes dhe përfundimit.<br>**Gjithsej** 2 pikë |
| • përsëritja e fjalëve dhe shprehjeve, dykuptimësia, përdorimi i kufizuar i fjalëve me gabime të shpeshta<br>**1 pikë** | • respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. të konstruksionit lidhur me, si për të, përdorimi i parafjalës për...)<br>**1 pikë**<br>• respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të vogla (p.sh. përdorimi i shenjave të pikësimit dhe drejtshkrimit, ndarja e fjalëve në fund të rreshtit, shkrimi i gabuar i fjalëve të huaja...)<br>**Gjithsej 2 pikë** | • lidhja e mirë në nivel të tekstit me palidhshmëri të përkohshme në shkallë të paragrafëve<br>**1 pikë** | • bën ndarjen e qartë të hyrjes, shtjellimit dhe përfundimit, por nuk ndan paragrafët brenda shtjellimit.<br>1 **pikë** |

# ZGJIDHJA E TESTIT NË PROVIMIN PROFESIONAL

**DETYRA 1. - 1 pikë**

1. substanca kimike natyrore dhe sintetike të cilat u shtohen produkteve

**DETYRA 2.**

Nxënësi fiton **1 pikë,** nëse ka shkruar, perifrazuar ose përshkruar fjalinë nga teksti me të cilën do të argumentojë qëndrimin e tij. Për shembull:

- Po, sepse mjeku Shlivançanin thotë se qytetarët duhet të kenë kujdes se çka blejnë dhe t'u shmangen produkteve me numrat e rrezikshëm E.
- Po. Në tekst thuhet: »Edukimi i popullatës për përdorimin e ruajtësve (konservansëve) të dëmshëm është i domosdoshëm, konsideron ai, dhe shton që qytetarët, derisa të mos përkujdeset në mënyrë serioze shteti për këtë problem, duhet që vetë të shikojnë se çfarë blejnë dhe kur t'i shikojnë numrat e rrezikshëm E, ta bojkotojnë atë produkt«.
- Përgjigjet, sepse qytetarët duhet të kenë kujdes për aditivët e rrezikshëm dhe ruajtësit ( konservanset). (dhe përgjigje të ngjashme)

**DETYRA 3.**

Nxënësi fiton **2 pikë,** nëse dallon që në këtë pjesë të tekstit flitet sesi përdorimi i artikujve të këtillë dëmton posaçërisht fëmijët. Për shembull:

- Artikujt në të cilët ka numra të rrezikshëm E, te fëmijët shkaktojnë sëmundje alergjike, të lëkurës dhe sëmundje malinje.
- Në sëmundjet alergjike, të lëkurës dhe sëmundjet malinje në moshën e fëmijëve.
- Substancat e rrezikshme në disa artikuj posaçërisht janë të dëmshme për shëndetin e fëmijëve dhe shkaktojnë alergji, tumore të rrezikshme, sëmundje të lëkurës.
- Alergji, sëmundje të lëkurës dhe sëmundje malinje. (dhe përgjigje të ngjashme)

Nxënësi merr **1 pikë,** nëse e kupton se emulgatorët shkaktojnë sëmundje, por nuk dallon se në këtë pjesë të tekstit bëhet fjalë për fëmijët.

- Tumoret e këqija, sëmundjet e enëve të gjakut, sëmundjet e traktit të zorrëve të lukthit, sëmundjet e mëlçisë dhe veshkave, sëmundjet e nervave.

- "Disa nga këta emulgatorë shkaktojnë sëmundjen e enëve të gjakut, sëmundjet e traktit të zorrëve të lukthit, sëmundja e mëlçisë dhe veshkave, sëmundjeve të lëkurës, kurse janë të dëmshëm edhe për nervat." (dhe përgjigje të ngjashme)

**DETYRA 4.**

Nxënësi merr **1 pikë,** nëse:

- rrethon numrin 3 dhe shpjegon se përbërësi i rrezikshëm është thartira e limonit ose E-330, sepse është emulgatori më i rrezikshëm që shkakton kancer.
- nuk ka rrethuar asnjë numër, por dallon se përbërësi i rrezikshëm është E-330, sepse shkakton kancer.
- ka rrethuar numrin 1 ose 2 (sipas të gjitha gjasave gabimisht), por dallon saktë emulgatorin e rrezikshëm-E-131 dhe argumenton saktë (shkakton kancerin). (dhe përgjigje të ngjashme)

**Vërejtje:** pranohet edhe nëse nxënësi veçon ngjyrën dhe E-130 dhe shpjegon se ka veçori kancerogjene.

Nxënësi merr **0 pikë** nëse:

- Rrethon saktë numrin 3, por veçon përbërësin e gabuar dhe emulgatorin. P.sh. shurupin e amidonit dhe E-102, sepse është i rrezikshëm.
- Nxënësi rrethon saktë numrin 3, por nuk jep sqarim.
- Nxënësi gabimisht rrethon numrin dhe sqaron gabimisht. P.sh. rrethon numrin 1 dhe veçon emulgatorin – lecitina e sojës.

**DETYRA 5. - 1 pikë**

2. Të paralajmërojë personat alergjikë në përbërjen e produktit.

**DETYRA 6. - 1 pikë**

4. Është ngritur në këmbën e majtë.

**DETYRA 7.**

Nxënësi merr **1 pikë,** nëse shkruan:

- Të ik.
- Vendosa të shkoj.
- Iki pa krye (dhe përgjigje të ngjashme)

**DETYRA 8. - 1 pikë**

3. Ndajfoljeve

**DETYRA 9. - 1 pikë**

3. katërqind e tridhjetë e një

**DETYRA 10.**

Nxënësi merr **1 pikë,** nëse i ka renditur saktë të gjitha epokat letrare:

1. **antika**
2. **mesjeta**
3. **rilindja**
4. **baroku**
5. **klasicizmi**
6. **romantizmi**
7. **realizmi**
8. **modernizmi**

**DETYRA 11. - 1 pikë**

4. romantizmit

**DETYRA 12. - 1 pikë**

2. rrëfimi i hallës

**DETYRA 13.**

Nxënësi merr **1 pikë,** nëse:

Ka shkruar - radio.

**DETYRA 14. - 1 pikë**

1. dallimin mes brezave

**DETYRA 15.**

Nxënësi merr **1 pikë** nëse:

Ka shkruar - gjinore.

**DETYRA 16. - 1 pikë**

2. të rimuara

**DETYRA 17. - 1 pikë**

1. kur shpreh hapur përbuzjen dhe urrejtjen

**DETYRA 18.**

Nxënësi merr **1 pikë,** nëse:

Ka shkruar - ujor.

**DETYRA 19.**

Nxënësi merr **1 pikë,** nëse:

Ka shkruar: Aristofani, letërsia antike.

**DETYRA 20.**

Nxënësi merr **1 pikë,** nëse:

Ka shkruar: shprehja e drejtpërdrejtë nga ana e poetit.

**DETYRA 21.**

Nxënësi merr **1 pikë,** nëse:

Ka shkruar - hero.

**DETYRA 22.**

Nxënësi merr **2 pikë,** nëse:

Ka shkruar: Hënë, kthjellët, shëtitje, zemër, thembër

Nxënësi merr **1 pikë,** nëse ka dhënë përgjigjen pjesërisht të saktë: tri kërkesa të plotësuara saktë.

**DETYRA 23.**

Nxënësi merr **2 pikë** nëse:

Ka shkruar: punoj, punim, punëtor, punësoj, përpunoj

Nxënësi merr **1 pikë,** nëse ka dhënë përgjigjen pjesërisht të saktë: tri kërkesa të plotësuara saktë.

**DETYRA 24.**

Nxënësi merr **2 pikë,** nëse:

Ka shkruar: miratoj, nderoj, thirrje, të lutem, zotim, kundrejt

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka dhënë përgjigjen pjesërisht të saktë: katër kërkesa të plotësuara saktë.

**DETYRA 25.**

Nxënësi merr **2 pikë,** nëse:

Ka shkruar: lajmin deri në 50 fjalë që ka në strukturë përgjigjet në pyetjet: kush, kur, ku, çka, përse, si? Pa gabime drejtshkrimore.

Nxënësi merr **1 pikë,** nëse ka hartuar lajmin me tri deri në katër përgjigje në strukturën e tij.

Nxënësi merr **0 pikë,** nëse ka hartuar lajmin me më pak se tri përgjigje në strukturën e tij.

**DETYRA 26.**

Nxënësi merr **2 pikë,** nëse:

Ka vendosura të gjitha shkronjat e mëdha dhe shenjat e duhura të pikësimit.

**A**i do **t'u** çonte nënave eshtrat e bijve të tyre që gjeneralët budallenj nuk ditën të udhëhiqnin në luftë**. Ai** ishte krenar për këtë**. Ai** do të bënte çmos**.**

**-Z**oti gjeneral**,** telefoni**...G**jenerali u ngrit plot gjallëri**. – M**ë falni**,** zotërinj**. – M**e hapa të gjatë dhe madhështorë shkoi në portinerinë e hotelit**.** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka hartuar lajmin me tri deri në katër përgjigje në strukturën e tij.

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka përgjigje të pjesshme të vendosura shkronjat e mëdha, por nuk ka shenja të pikësimit ose e kundërta, **apo 10 shenja dhe shkronja** të vendosura saktë

**DETYRA 27.**

Nxënësi merr **1 pikë,** nëse:

Ka shkruar - zhveshur.

**DETYRA 28.**

Nxënësi merr **1 pikë,** nëse:

Ka shkruar – Petrarka – Humanizmi dhe Renesanca.

**DETYRA 29.**

Nxënësi merr **2 pikë,** nëse:

Ka zbërthyer- At (rrënjë) –dhe (rrënjë) –dashur (rrënjë) –i (mbaresë)

Nxënësi merr **1 pikë,** nëse ka zbërthyer dy pjesë saktësisht.

## DETYRA 30. - Skema për vlerësimin e e-mailit (10 pikë)

| Përmbajtja | Drejtshkrimi | Lidhshmëria | Struktura ndërtimore e tekstit |
|---|---|---|---|
| Teksti<br>• plotësisht i përgjigjet temës së dhënë<br>• përmban të gjitha të dhënat e shtruara<br>• ka formën gjegjëse<br>**2 pikë** | • vlerësohet respektimi i normave drejtshkrimore. Përdorimi i gjuhës standarde, me gabime minimale.<br>• shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe. Përdorimi me vend i shenjave të pikësimit.<br>**Gjithsej 4 pikë** | • Lidhja e mirë në nivel të tekstit dhe paragrafëve.<br>**2 pikë** | • Lidhja e mirë e organizimit të përgjithshëm dhe formës grafike të tekstit me strukturën e saj logjike (ndan qartë të adresuarin, nga adresuesi, fut përshëndetjen, përshëndetjen përfunduese, nënshkrimin, ndan paragrafët)<br>**2 pikë** |
| • testi i përgjigjet temës së shtruar, por mungon një nga të dhënat e dhëna: Taulant Gashi; taulant.gashi@T-com.me;përfunduar shkallën IV, drejtimi kamarier; 18 vjeç; njohja e gjuhës angleze dhe gjuhës italiane; 4 muaj përvojë në hotelin »Mediteran« në Ulqin ose<br>• hartimi i fletëparaqitjes i përgjigjet temës së dhënë, janë të pranishme të gjitha të dhënat e dhëna, por nga këndvështrimi i formës i mungon një apo dy elemente (adresuesi, emri i të adresuarit, përshëndetja hyrëse, përshëndetja përfunduese, nënshkrimi<br>**1 pikë** | • respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (gabimet e tipit: lidhur me atë, duke marrë parasysh që, përzierja semantike e parafjalës për shkak dhe për ...)<br>**1 pikë**<br>• respektimi i normës gjuhësore me gabime të vogla (gabime të vogla në vendosjen e shenjave të pikësimit, gabimeve në ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit, gabime në transkriptim të fjalëve të huaja...)<br>**Gjithsej 2 pikë** | • lidhshmëria e mirë në nivel të tekstit me palidhshmëri të përhershme në nivel të paragrafëve<br>**1 pikë** | • palidhshmëria e përkohshme e organizimit të përgjithshëm dhe formës grafike të tekstit me strukturën e tij logjike (nuk shkruan të adresuesin në vendin përkatës, nuk shkruan adresuesin në vendin e duhur, përshëndetjen dhe ngjashëm)<br>**1 pikë** |

# SKEMA PËR VLERËSIMIN E ESEVE NË PROVIMIN E MATURËS

## ESEJA 1:
## MOTIVI I SAKRIFIKIMIT NË POEZINË *”VDEKJA E NOSITIT” të Lasgush Poradecit*

**Përmbajtja: 30 pikë**

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 1.** | Nxënësi thekson:<br>1. se «Vdekja e Nositit« është një poezi lirike (1 pikë)<br>2. se autori këtë poezi e ka shkruar në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore (1 pikë)<br>**Gjithsej 2 pikë** |
| **Kërkesa 2.** | Nxënësi thekson:<br>1. se motivi qendror i poezisë është sakrifikimi i poetit përmes veprës poetike për të mirën e përgjithshme<br>**1 pikë** |
| **Kërkesa 3.** | Nxënësi thekson:<br>1. se poeti përdor vargun tetërrokësh (1 pikë)<br>2. se poezia është e përbërë nga gjashtë strofa trevargëshe dhe një strofë katër-vargëshe, të gjitha të rimuara (1 pikë)<br>3. se poezia rrëfehet në vetën e parë, si monolog (1 pikë)<br>4. se figurat mbizotëruese stilistike janë metafora dhe aliteracioni (1 pikë)<br>**Gjithsej 4 pikë** |
| **Kërkesa 4.** | Nxënësi thekson:<br>1. se kujt i drejtohet heroi lirik i kësaj poezie (1 pikë)<br>2. se Nositi simbolizon poetin (1 pikë)<br>3. se sakrifikimi bëhet nga dashuria për të tjerët(1 pikë)<br>4. se akti i krijimit përngjan me aktin e hapjes së gjirit të Nositit për t’i ushqyer zogjtë e vet me gjakun e tij (1 pikë)<br>5. për gjuhën e zjarrtë, plot me emocione që e përshkon poezinë (1pikë)<br>6. për atmosferën që mbizotëron në këtë poezi (1 pikë)<br>**Gjithsej 6 pikë** |

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 5.** | Nxënësi thekson:<br>1. se vargu i parë dhe vargu i fundit janë të njëjtë dhe (nxënësi) shpreh mendimin e tij për efektin që krijon ky veprim i poetit<br>**1 pikë** |
| **Kërkesa 6.** | Nxënësi:<br>1. vëren se poeti përdor figurën e personifikimit (shpirtëzimit) të liqenit<br>**1 pikë** |
| **Kërkesa 7.** | Nxënësi:<br>1. gjatë hartimit të esesë përdor citate nga poezia dhe pastaj shpreh mendimet e veta për to<br>**1 pikë** |

**VËREJTJE: Të gjitha kërkesat shumëzohen me 2, përveç kërkesës 1.**

## Gjuha dhe struktura e tekstit

### Kërkesa 8.

- **Leksiku**

  Vlerësohet:

  1. origjinaliteti (interpreton me fjalë të veta, eseja nuk bazohet vetëm në parafrazime dhe përsëritje të formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, shprehshmëria (1 pikë)
  2. të shprehurit e qartë dhe të saktë, pa dykuptimësi, struktura e fjalisë me stil (1 pikë)

***Gjithsej 2 pikë***

### Kërkesa 9.

- **Gramatika**

  Vlerësohet:

  1. përdorimi i drejtë i rasave (1 pikë)
  2. shkrimi i saktë i formave foljore, përdorimi i natyrshëm i sintaksës së shqipes (shmangia e përdorimit të ndërtimeve të huaja), zbatimi i rregullt i rregullave të kongruencës (përputhjes) (1 pikë)
  3. dallimi semantik i parafjalëve për dhe mbi ose përemrit i vet/ i tij ose përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit lidhur me këtë, duke marrë parasysh ose përemrave që, i cili, e cila, të cilët etj. (1 pikë)

***Gjithsej 3 pikë***

**Kërkesa 10.**

- **Drejtshkrimi**

  Vlerësohet:

  1. shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, shkrimi i fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese (1 pikë)
  2. zbatimi i njohurive për alternimet e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores ë, zbatimi i rregullave sipas së cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j (bukuria, dashuria etj.), duke pasur parasysh disa përjashtime Lirijes, Selvijes, Mihrijes, Hajrijes) (1pikë)
  3. përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit (pika në fund të fjalisë, te shkurtesat, pikëpresja, pikëpyetja, pikëçuditja, presja (te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse...) (1 pikë)

........................................ ***Gjithsej 3 pikë***

**Kërkesa 11.**

- **Lidhshmëria**

  Vlerësohet:

  1. lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit
  2. lidhshmëria e mirë në nivelin e paragrafëve (1 pikë)

........................................ ***Gjithsej 1 pikë***

**Kërkesa 12.**

- **Struktura e tekstit**

  1. numri i fjalëve prej 250 deri në 300 1 pikë
  2. teksti i strukturuar (hyrja, zhvillimi, përfundimi)
  3. ndarja e paragrafëve brenda esesë, sidomos në pjesën kryesore të esesë (1 pikë)

........................................ ***Gjithsej 3 pikë***

- VËREJTJE:

  **Kërkesa 11 shumëzohet me 2.**

  **Kërkesa 12 nën 2 shumëzohet me 2.**

# ESEJA 2: *”PLAKU DHE DETI”- Ernest Heminguej*

## Përmbajtja – 30 pikë

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 1.** | Nxënësi thekson:<br>1. cilës letërsi i përket vepra letrare “Plaku dhe deti” (1 pikë)<br>**Gjithsej 1 pikë** |
| **Kërkesa 2.** | Nxënësi thekson:<br>1. formën letrare të kësaj vepre (1 pikë)<br>**1 pikë** |
| **Kërkesa 3.** | Nxënësi thekson:<br>1. autorin e veprës si njërin nga shkrimtarët amerikanë më në zë të shekullit të kaluar e përfaqësues kryesor të “brezit të humbur” (1 pikë)<br>2. çmimin që ka marrë Heminguej për krijimtarinë që kulmoi me këtë kryevepër (1 pikë)<br>3. cila veti e personazhit (plakut) theksohet më shumë (1 pikë)<br>4. psikologjinë e plakut Santiago (1 pikë)<br>5. raportin e djaloshit Manolin me plakun Santiago, çka sheh ai te plaku (1 pikë)<br>6. teknikën shkrimore (formacionin stilistik-letrar) (1 pikë)<br>**Gjithsej 6 pikë** |
| **Kërkesa 4.** | Nxënësi thekson:<br>1. narratorin e veprës (1 pikë)<br>2. vendin e shtjellimit të ngjarjes në këtë vepër (1 pikë)<br>**Gjithsej 2 pikë** |
| **Kërkesa 5.** | Nxënësi thekson:<br>1. personazhet e tjera (1 pikë)<br>**Gjithsej 1 pikë** |
| **Kërkesa 6.** | Nxënësi thekson:<br>1. temën e veprës, simbolikën e peshkaqenëve (1 pikë)<br>2. gjuhën e veprës (1 pikë)<br>3. porosinë kryesore të veprës sipas mendimit të vet (1 pikë)<br>**Gjithsej 3 pikë** |
| **Kërkesa 7.** | Nxënësi:<br>1. shpreh përshtypjet e veta për luftën që zhvillon plaku me peshkaqenin dhe durimin që e karakterizon<br>**Gjithsej 1 pikë** |

**VËREJTJE: Të gjitha kërkesat shumëzohen me 2.**

## Gjuha dhe struktura e tekstit

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 8.**<br><br>**- Leksiku** | Vlerësohet:<br>1. origjinaliteti, pasuria e gjuhës, shprehjet e figurshme (1 pikë)<br>2. të shprehurit e qartë dhe të saktë, pa dykuptimësi, struktura e fjalisë me stil (1 pikë)<br>3. përdorimi i drejtë i fjalëve dhe shprehjeve(1 pikë)<br>**Gjithsej 3 pikë** |
| **Kërkesa 9.**<br><br>**- Gramatika** | Vlerësohet:<br>1. përdorimi i drejtë i rasave (1 pikë)<br>2. shkrimi i saktë i formave foljore, (koha e kryer, koha e tashme, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja) (1pikë)<br>3. zbatimi i rregullt i rregullave të kongruencës (përputhjes), përdorimi i saktë i gjinisë së përemrave, shmangia e dialektizmave dhe ndërtimeve sintaksore të huaja(1 pikë)<br>4. dallimi semantik i parafjalëve për dhe mbi, ose përemrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave që, i cili, e cila, të cilët etj. (1pikë)<br>**Gjithsej 4 pikë** |
| **Kërkesa 10.**<br><br>**- Drejtshkrimi** | Vlerësohet:<br>1. shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave dh/ll, ç/q, gj/xh, e/ë, shkrimi i saktë i numrave, shkrimi i fjalëve bashkë dhe ndaras, (1 pikë)<br>*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*<br>2. shkrimi i saktë i trajtës mohuese, apostrofit (1 pikë)<br>*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*<br>3. zbatimi i njohurive për alternimet e zanoreve (1 pikë)<br>4. përdorimi i drejtë i zanores ë, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j (bukuria, dashuria etj), duke pasur parasysh disa përjashtime (Lirijes, Selvijes, Mihrijes, Hajrijes) (1pikë)<br>*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*<br>5. përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit (pika në fund të fjalisë, te shkurtesat, pikëpresja, pikëpyetja, pikëçuditja, presja (te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse...) (1 pikë)<br>*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*<br>**Gjithsej 5 pikë** |
| **Kërkesa 11.**<br><br>**- Lidhshmëria** | Vlerësohet:<br>1. lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit (1pikë)<br>**Gjithsej 1 pikë** |
| **Kërkesa 12.**<br><br>**- Struktura e tekstit** | 1. teksti i strukturuar (hyrja, shtjellimi, përfundimi) (1 pikë)<br>2. ndarja e paragrafëve brenda esesë, sidomos në pjesën e shtjellimit të esesë (1 pikë)<br>**Gjithsej 2 pikë** |

# ESEJA 3:
# ”HISTORIA E SKËNDERBEUT”*e Marin Barletit*

**Përmbajtja – 30 pikë**

**Kërkesa 1.**

Nxënësi thekson:

1. epokën letrare së cilës i takon “Historia e Skënderbeut”, burimin që paraqet kjo vepër për jetën e heroit tonë kombëtar (1 pikë)
2. idetë e Barletit në “Historinë e Skënderbeut” (1 pikë)
3. çështjen e lirisë dhe të drejtës që mbron popullli shqiptar dhe Skënderbeu (1 pikë)

***Gjithsej 3 pikë***

**Kërkesa 2.**

Nxënësi thekson:

1. zotësinë oratorike të Skënderbeut (1 pikë)
2. trimërinë e Skënderbeut (1 pikë)
3. strategjinë ushtarake të Skënderbeut (1 pikë)
4. karakteristikat historiko-letrare të veprës (1 pikë)
5. gjuhën latine si gjuhë, në të cilën është shkruar vepra (1 pikë)
6. figurat letrare në vepër (1 pikë)

***Gjithsej 6 pikë***

**Kërkesa 3.**

Nxënësi thekson:

1. stilin që përdor autori në këtë vepër (1 pikë)
2. narracionin e pasur (përshkrimet) në vepër
3. frymën që e përshkon veprën (1 pikë)

***Gjithsej 3 pikë***

**Kërkesa 4.**

Nxënësi thekson:

4. rrethanat historike e letrare të kohës së realizimit të veprës së Barletit “Historia e Skënderbeut” (1 pikë)

5. shkruan për konceptin humanist për historinë që ndihet në "Historinë e Skënderbeut" (1 pikë)
6. shkruan për mesazhin që sjell autori përmes veprës "Historia e Skënderbeut" (1 pikë)

***Gjithsej 3 pikë***

**VËREJTJE: Të gjitha kërkesat shumëzohen me 2.**

**Gjuha dhe struktura e tekstit**

**Kërkesa 5.**

- **Leksiku**

Vlerësohet:

1. origjinaliteti, pasuria e gjuhës dhe të shprehurit (1 pikë)
2. të shprehurit e qartë dhe të saktë, pa dykuptimësi, struktura e fjalisë me stil (1 pikë)
3. përdorimi i saktë i fjalëve dhe shprehjeve(1 pikë)

***Gjithsej 3 pikë***

**Kërkesa 6.**

- **Gramatika**

Vlerësohet:

1. përdorimi i drejtë i rasave (1 pikë)
2. shkrimi i saktë i formave foljore, (koha e kryer, koha e tashme, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja) (1pikë)

*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

3. zbatimi i rregullt i rregullave të kongruencës (përputhjes) (1pikë)
4. dallimi semantik i parafjalëve për dhe mbi, pastaj i përemrit i vet/ i tij dhe përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit lidhur me këtë, duke marrë parasysh, si dhe i përemrave që, i cili, e cila, të cilët etj. (1pikë)

*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

***Gjithsej 4 pikë***

**Kërkesa 7.**

- **Drejtshkrimi**

Vlerësohet:

1. shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave dh / ll, ç/q, gj/xh, e/ë, shkrimi i saktë i numrave, shkrimi i fjalëve bashkë dhe ndaras (1 pikë)

*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

2. shkrimi i saktë i trajtës mohuese, apostrofit (1 pikë)
   *(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*
3. zbatimi i njohurive për alternimet e zanoreve (1 pikë)
4. përdorimi i drejtë i zanores ë, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j (bukuria, dashuria etj), duke pasur parasysh disa përjashtime (Lirijes, Selvijes, Mihrijes, Hajrijes) (1pikë)
   *(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*
5. përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit (pika në fund të fjalisë, te shkurtesat, pikëpresja, pikëpyetja, pikëçuditja, presja (te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse...) (1 pikë)
   *(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

***Gjithsej 5 pikë***

**Kërkesa 8.**

- **Lidhshmëria**

  Vlerësohet:

1. lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit (1pikë)

***Gjithsej 1 pikë***

**Kërkesa 9.**

- **Struktura e tekstit**

1. teksti i strukturuar (hyrja, shtjellimi, përfundimi) (1 pikë)
2. ndarja e paragrafëve brenda shtjellimit të esesë (1 pikë)

***Gjithsej 2 pikë***

## ESEJA 4:
## *„DUKE PRITUR GODONË "- S. Beket*

**Përmbajtja – 30 PIKË**

**Kërkesa 1.**

Nxënësi thekson:

1. se kjo vepër është dramë e absurdit antidramë (1 pikë)
2. shkrimtarin/shkrimtarët e dramës së absurdit (p.sh. E. Jonesko, A. Adamov... (1 pikë)

3. karakteristikat e këtij lloji të dramës (p.sh. antidrama apo drama e absurdit ndryshon krejtësisht nga drama klasike, pra nuk ka kompozicion të zakonshëm të dramës dhe as konflikt; nuk ka ngjarje - as fillim, kohëzgjatje dhe as zhvillim; nuk ka unitet psikologjik të personazhit, personazhet janë antiheronj - nuk dihet se kush janë, nga janë, çka dëshirojnë... dhe përgjigje të ngjashme të sakta) (1 pikë)

*Gjithsej 3 pikë*

**Kërkesa 2.**

Nxënësi:

1. thekson se drama ka dy akte (1 pikë)
2. përshkruan pamjen e skenës, thekson ngjashmëritë dhe dallimet në strukturën e akteve (p.sh. gjithçka ndodh në hapësirë të njëjtë, afër pemës – në aktin e parë pema është pa gjethe, në aktin e dytë pema ka gjethe ...dhe përgjigje të ngjashme të sakta (1 pikë)
3. e përshkruan Vladimirin - sjelljen e tij në skenë, si dhe gjërat e rëndësishme që kanë të bëjnë me të (p.sh. Vladimiri është më i kulturuar, më i arsimuar sesa Estragoni, i sqaron atij shumë kuptime...(1 pikë)
4. e përshkruan Estragonin – sjelljen e tij në skenë, si dhe gjërat e rëndësishme që kanë të bëjnë me të (p.sh. është më i vogël, më i dobët, më spontan se Vladimiri, i është nënshtruar vullnetarisht (1 pikë)

**OSE:** nuk i përshkruan veçanërisht Vladimirin dhe Estragonin, por më tepër thekson sjelljen e tyre - p.sh. nuk janë të sigurt në të djeshmen dhe të sotmen, në kohë; shkrimtari thotë se janë Estragoni dhe Vladimiri kurse ata paraqiten si Didi dhe Gogo, derisa Pocit dhe Likit i paraqiten si Katuli dhe Alberti; Vladimiri është rezonues i dramës i cili thotë se koha kalon ngadalë dhe se shkurtohet me ngjarjet që në shikim të parë mund të duken të arsyeshme, derisa mos të bëhen shprehi; Estragoni është poet, i cili e pyet veten mos vallë nuk shihet se është poet duke treguar në kostumin e tij të vjetër dhe të shqyer; në episodin me Pocin dhe Likin sillen sikur shikojnë shfaqjen dhe provojnë të kuptojnë paraqitjen e tyre dhe marrëdhëniet në mes tyre...(2 pikë) **OSE:** nxënësi tregon për paqëndrueshmërinë njerëzore (në fillim Vladimiri dhe Estragoni dënojnë Pocon për sjelljen e tij ndaj Likit, e më pas ia kthejnë shpinën Likit, sepse gjoja ka sjellje të papërgjegjshme ndaj njeriut të mirë dhe zotërisë); përmes Vladimirit dhe Estragonit nxënësi vë theksin në kriteret e humbura, sjelljet e tyre joserioze në situata serioze, por edhe në vetëdijen për shpresën, sepse ata, edhe pse Godo nuk vjen, edhe më tej presin...dhe përgjigje të ngjashme të sakta (2 pikë)

5. thekson sjelljen e Pocos dhe Likit (p.sh. Poco është pasanik, ai është zotëri dhe me shërbëtorin e vet Likin e drejton me ndihmën e litarit që i është i mbështjellë rreth qafës së Likit; Liki është i varfër dhe i përulur para padronit të tij dhe e dëgjon pa asnjë kundërshtim; në fund të antidramës mësohet se Liki është shurdhmemec, kurse Poco është verbëruar (1 pikë)
6. thekson rolin e tyre në strukturën e dramës (p.sh. funksioni i episodit me Pocon dhe me Gëzimin (Likin) është që të krijohet iluzioni se prapëseprapë diçka do të ndodhë (1 pikë)
7. thekson vogëlushin që sjell lajmin nga Godoja dhe/ose komenton porosinë e tij se do të vijë të nesërmen (1 pikë)

***Gjithsej 7 pikë***

**Kërkesa 3.**

Nxënësi thekson:

1. rolin e gjuhës dhe mënyrën në të cilën flasin heronjtë (p.sh. gjuha është e reduktuar, dialogët janë të pakuptimtë, ka lojë me fjalë, mosmarrëveshje verbale, paqartësi, ka shumë gjeste, mimikë, lëvizje... dhe përgjigje të ngjashme të sakta) (1 pikë)
2. shtresën reale të dramës duke apostrofuar se ky është një tregim për dy endacakë të cilët në pamundësi që të vendosin se çka do të duhej të bëhet nuk bëjnë asgjë dhe përgjigje të ngjashme të sakta) (1 pikë)
3. shtresën metafizike të dramës (p.sh. nxënësit i kujtohen fjalët e Vladimirit që ata paraqesin njerëzimin dhe përgjigje të ngjashme të sakta) (1 pikë);

   **OSE:** nëse nuk i ndan shtresën reale dhe metafizike të dramës, por shkruan se Poco është njeri i fuqishëm me litar në dorë, Liki i pafat me litar rreth qafës dhe Vladimiri e Estragoni varfanjakë dhe përgjigje të ngjashme të sakta) (1 pikë)

***Gjithsej 3 pikë***

**Kërkesa 4.**

Nxënësi:

1. në formë të përfundimit sqaron titullin e veprës (p.sh. pritja e shpëtimit nga Zoti/ e lidh fjalën Godo me kuptimin e saj në gjuhën angleze/ të përmendurit e tregimeve biblike/Godo është gjithçka nga i cili pritet shpëtimi... dhe përgjigje të ngjashme të sakta) (1 pikë)
2. shpreh si e kupton ai vetë porosinë e dramës së Beketit – është me rëndësi të përmendet pritja e kotë (1 pikë)

***Gjithsej 2 pikë***

**VËREJTJE: Të gjitha kërkesat shumëzohen me 2.**

**Gjuha dhe struktura e tekstit**

**Kërkesa 5.**

- **Leksiku**

Vlerësohet:

1. origjinaliteti, pasuria e gjuhës dhe të shprehurit (1 pikë)
2. të shprehurit e qartë dhe të saktë, pa dykuptimësi, struktura e fjalisë me stil (1 pikë)
3. përdorimi i saktë i fjalëve dhe shprehjeve(1 pikë)

***Gjithsej 3 pikë***

**Kërkesa 6.**

- **Gramatika**

Vlerësohet:

1. përdorimi i drejtë i rasave (1 pikë)
2. shkrimi i saktë i formave foljore, (koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja) (1pikë)
   *(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*
3. zbatimi i rregullt i rregullave të kongruencës (përputhjes), përdorimi i saktë i gjinisë së përemrave, shmangia e dialektizmave dhe ndërtimeve sintaksore të huaja(1 pikë)
4. dallimi semantik i parafjalëve për dhe mbi, ose përemrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave që, i cili, e cila, të cilët etj. (1pikë)
   *(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

***Gjithsej 4 pikë***

**Kërkesa 7.**

- **Drejtshkrimi**

Vlerësohet:

1. shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave dh/ ll, ç/q, gj/xh, e/ë, shkrimi i saktë i numrave, shkrimi i fjalëve bashkë dhe ndaras (1 pikë)
   *(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*
2. shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit (1 pikë)

*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

3. zbatimi i njohurive për alternimet e zanoreve (1 pikë
4. përdorimi i drejtë i zanores **ë**, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja ***j*** (bukuria, dashuria etj), duke pasur parasysh disa përjashtime (Lirijes, Selvijes, Mihrijes, Hajrijes) (1pikë)

*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

5. përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit (pika në fund të fjalisë, te shkurtesat, pikëpresja, pikëpyetja, pikëçuditja, presja (te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse...) (1 pikë)

*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

***Gjithsej 5 pikë***

**Kërkesa 8.**

- **Lidhshmëria**

Vlerësohet:

1. lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit (1pikë)

***Gjithsej 1 pikë***

**Kërkesa 9.**

- **Struktura e tekstit**

Vlerësohet:

1. teksti i strukturuar (hyrja, shtjellimi, përfundimi) (1 pikë)
2. ndarja e paragrafëve brenda shtjellimit të esesë (1 pikë)

***Gjithsej 2 pikë***

## ESEJA 5:
## *”GJENERALI I USHTRISË SË VDEKUR”- Ismail Kadare*

**Përmbajtja – 30 pikë**

**Kërkesa 1.**

Nxënësi thekson:

1. epokën letrare së cilës i takon “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, (d.m.th. letërsisë moderne ose bashkëkohore) (1 pikë)

***Gjithsej 1 pikë***

**Kërkesa 2.**

Nxënësi thekson:

1. idenë kryesore të autorit në veprën "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" dhe sintagmën ushtri e vdekur (1 pikë)

   *(Nxënësi merr 1 pikë, nëse thekson vetëm idenë kryesore të autorit në këtë vepër, kurse 2 pikë, nëse shpjegon sintagmën ushtri e vdekur)*

***Gjithsej 2 pikë***

**Kërkesa 3.**

Nxënësi thekson:

1. çfarë simbolizon abstraksioni i ushtrisë së vdekur (1 pikë)

***Gjithsej 1 pikë***

**Kërkesa 4.**

Nxënësi thekson:

1. lidhshmërinë e fabulës së këtij romani me ndonjë baladë popullore shqiptare, krijimin e portretit të shqiptarit liridashës, human dhe fisnik në vepër(1 pikë)

   *(Nxënësi merr 1 pikë, nëse thekson vetëm lidhshmërinë e fabulës së këtij romani me ndonjë baladë popullore shqiptare, kurse 2 pikë, nëse thekson edhe portretin e shqiptarit liridashës, human dhe fisnik në vepër)*

***Gjithsej 2 pikë***

**Kërkesa 5.**

Nxënësi thekson:

1. rolin e priftit dhe të gjeneralit (1 pikë)
2. ushtrinë e vdekur që zhvarroset dhe paketohet në thasë najloni (1 pikë)
3. paraqitjen e ndëshkimit moral të gjeneralit në raport me të kaluarën (1 pikë)

***Gjithsej 3 pikë***

**Kërkesa 6.**

Nxënësi thekson:

1. momentin e thyerjes së moralit të gjeneralit në dasmën shqiptare (1 pikë)
2. plakën Nicë që mishëron humanizmin dhe heroizmin për lirinë (1 pikë)
3. rrethanat historike e letrare të veprës "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" (1 pikë)
4. se "lëvizja" e të vdekurve është përftesa groteske më e fuqishme (1 pikë)

***Gjithsej 4 pikë***

**Kërkesa 7.**

Nxënësi thekson:

1. se vepra rikrijon itinerarin e krimeve dhe të dështimeve të ushtrisë pushtuese (1 pikë)
2. gjuhën, figurat, stilin dhe teknikat e tjera të përdorura nga autori për të arritur efektet e caktuara artistike (1 pikë)

   *(Nxënësi merr 1 pikë, nëse thekson vetëm rikrijimin e itinerarit të krimeve dhe të dështimeve të ushtrisë pushtuese, kurse 2 pikë, nëse përmend edhe gjuhën që përdor autori i kësaj vepre, disa nga figurat, stilin dhe teknikat që ka përdorur Kadare për të arritur efekte të caktuara artistike)*

***Gjithsej 2 pikë***

**VËREJTJE: Të gjitha kërkesat shumëzohen me 2.**

**Gjuha dhe struktura e tekstit**

**Kërkesa 8.**

- **Leksiku**

Vlerësohet:

1. pasuria e gjuhës dhe të shprehurit (qasje krijuese ndaj temës) (1 pikë)
2. të shprehurit e qartë dhe të saktë, pa dykuptimësi, struktura e fjalisë me stil (1 pikë)
3. përdorimi i saktë i fjalëve dhe shprehjeve (1 pikë)

***Gjithsej 3 pikë***

**Kërkesa 9.**

- **Gramatika**

Vlerësohet:

1. përdorimi i drejtë i rasave (1 pikë)
2. shkrimi i saktë i formave foljore, (koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja) (1pikë)

*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

| **Kërkesa 2.** | Nxënësi:<br>1. thekson se ç’ punë do të dëshironte të bënte (p.sh. bibliotekar, lektor, floktar, kamerier, ëmbëltor, pilot, mjek...(1 pikë)<br>2. e përshkruan atë punë dhe jep argumente përse do të dëshironte të merrej me atë punë (3 pikë)<br>**Vërejtje:** Nëse nxënësi shkruan se do të dëshironte të jetë p.sh. bibliotekar, sepse i adhuron librat dhe në këtë mënyrë do të kishte gjithmonë qasje në to, meqë gjithmonë është i rrethuar me libra, merr ***(1 pikë)***<br>Nëse e jep sqarimin më të plotë, merr **2 pikë.** (P.sh. gjithmonë do të jem i/e rrethuar me libra dhe do të kisha qetësinë time në të cilën do të mund të lexoja atë që më dëshiron zemra në atë moment, nga klasikët rusë deri te bestsellerët më të rinj dhe beletristika dhe përgjigje të ngjashme.)<br>Nëse e sqaron me stil dhe e argumenton qartë, merr **3 pikë**. (P.sh. pasi që t’i ndihmoj lexuesit ta gjejë dhe ta fitojë librin e dëshiruar, i kthehem botës sime të librave në të cilën në një çast jam Vronski, kurse në tjetrin Vuk Mandushiqi trim dhe i dashuruar, ndërsa në të tretin Bora Stankoviq. Por në Gjakun tim të papastër Sofka nuk do të mbetej vetëm dhe pa dashuri dhe nuk do të shkarravite e dëshpëruar nëpër hi, por do të ishte edhe më tej bërthamë, e re, e stërmbushur me dashuri dhe e rrethuar me fëmijë dhe të qeshurat e tyre...dhe përgjigje të ngjashme)<br>**Gjithsej 4 pikë** |
| **Kërkesa 3.** | Nxënësi:<br>1. kumton se çka mendojnë bashkëmoshatarët e tij për vullnetarizmin (se është i dobishëm apo se nga ai nuk ka asnjë dobi (1 pikë)<br>2. shpreh argumente përse puna pa pagesë është e dobishme (p.sh. u mundëson përgatitjen psikologjike dhe profesionale për kryerjen më të suksesshme të punës dhe përgjigje të ngjashme), përkatësisht se nuk sjell asnjë dobi (p.sh. u merr kohë që mund ta shfrytëzonin në argëtim dhe zbavitje, shoqërim me miq dhe përgjigje të ngjashme) (1 pikë)<br>**Gjithsej 2 pikë** |

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 4.** | Nxënësi kumton:<br>1. përparësitë e punës vullnetare (p.sh. arritja e njohurive praktike, njohja me punën, përvoja e punës...(1 pikë)<br>2. mangësitë e punës vullnetare (p.sh. nuk ka përfitime materiale/punohet pa pagesë/askush nuk dëshiron të punojë pa kompensim/nuk ka kohë për vullnetarizëm, sepse merr kohë të çmuar dhe përgjigje të ngjashme (1 pikë)<br>**Gjithsej 2 pikë** |
| **Kërkesa 5.** | Nxënësi kumton:<br>1. vendimin e vet (p.sh. do të pranoja verës të punoj vullnetarisht) (1 pikë)<br>2. argumentet për vendimin e vet (p.sh. nuk kam obligime, prandaj mund të bëj diçka të dobishme/të fitoj përvojë të caktuar ose t'i ndihmoj dikujt dhe përgjigje të ngjashme (1 pikë)<br>**Gjithsej 2 pikë** |
| **Kërkesa 6.** | Nxënësi:<br>1. kumton përcaktimin e vet (vullnetarizmi është përsosje profesionale ose vullnetarizmi është kohë e humbur (1 pikë)<br>2. shpreh argumentet për përcaktimin e vet (p.sh. vullnetarizmi na mundëson që të fitojmë përvojë të caktuar dhe dije, e cila mund të jetë "trampolinë" ose përparësi me rastin e punësimit. Sot me rastin e punësimit kërkohet më shpesh përvoja e caktuar e punës apo rekomandimi i punëdhënësit të mëparshëm./Për mjaft të rinj kjo është e vetmja mënyrë që pas përfundimit të shkollës së mesme apo fakultetit të fitojnë përvojë të caktuar dhe në këtë mënyrë edhe përparësi ndaj kandidatëve të tjerë me rastin e punësimit. OSE: Duhet të fitoj diçka në mënyrë që të kem të hollat e mija, që të kem mundësi të udhëtoj dhe ngjashëm, ndërkohë që vullnetarizmi ma mundëson këtë. Kam kënaqësi të punoj punën që e dua, por më kot kur nga kjo nuk mund të jetoj dhe përgjigje të ngjashme (2 pikë)<br>**Vërejtje:**<br>Nëse nxënësi në **kërkesën 6.2** e përsërit argumentin të cilin e ka përmendur në njërën nga kërkesat e mëparshme, merr vetëm **1 pikë**<br>**Gjithsej 3 pikë** |

**VËREJTJE: Të gjitha kërkesat shumëzohen me 2.**

## Gjuha dhe struktura e tekstit

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 7.**<br>**- Leksiku** | Vlerësohet:<br>1. pasuria e gjuhës dhe të shprehurit (qasje krijuese ndaj temës pikë)<br>2. të shprehurit e qartë dhe të saktë, pa dykuptimësi, struktura e fjalisë me stil (1 pikë)<br>3. përdorimi i saktë i fjalëve dhe shprehjeve(1 pikë)<br>**Gjithsej 3 pikë** |

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 8.**<br><br>**-Gramatika** | Vlerësohet:<br>1. përdorimi i drejtë i rasave (1 pikë)<br>2. shkrimi i saktë i formave foljore, (koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja) (1pikë)<br>3. (Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)<br>4. zbatimi i rregullt i rregullave të kongruencës (përputhjes), përdorimi i saktë i gjinisë së përemrave, shmangia e dialektizmave dhe ndërtimeve sintaksore të huaja(1 pikë)<br>5. (Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)<br>6. dallimi semantik i parafjalëve për dhe mbi, ose përemrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave që, i cili, e cila, të cilët etj. (1pikë)<br>*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*<br>**Gjithsej 4 pikë** |
| **Kërkesa 9.**<br><br>**- Drejtshkrimi** | Vlerësohet:<br>1. shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave r/rr, dh/ll, k/q, s/z, k/g, ç/q, gj/xh, e/ë, shkrimi i saktë i numrave, shkrimi i fjalëve bashkë dhe ndaras (1 pikë)<br>*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*<br>2. shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit (1 pikë)<br>*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*<br>3. zbatimi i njohurive për alternimet e zanoreve (1 pikë)<br>*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*<br>4. përdorimi i drejtë i zanores ë, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j (bukuria, dashuria etj), duke pasur parasysh disa përjashtime (Lirijes, Selvijes, Mihrijes, Hajrijes) (1pikë)<br>*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*<br>5. përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit (pika në fund të fjalisë, te shkurtesat, pikëpresja, pikëpyetja, pikëçuditja, presja (te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse...) (1 pikë)<br>*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*<br>**Gjithsej 5 pikë** |
| **Kërkesa 10.**<br><br>**- Lidhshmëria** | Vlerësohet:<br>1. lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit (1pikë)<br>**Gjithsej 1 pikë** |
| **Kërkesa 11.**<br><br>**- Struktura e tekstit** | Vlerësohet:<br>1. teksti i strukturuar (hyrja, shtjellimi, përfundimi) (1 pikë)<br>2. ndarja e paragrafëve brenda shtjellimit të esesë (1 pikë)<br>**Gjithsej 2 pikë** |

# SKEMA PËR VLERËSIMIN E ESESË NË PROVIMIN PROFESIONAL

## ESEJA 1:
## MOTIVI I SAKRIFIKIMIT NË POEZINË *”VDEKJA E NOSITIT” të L. Poradecit*

**Përmbajtja**

**Kërkesa 1.**

Nxënësi thekson:

1. se «Vdekja e Nositit« është një poezi lirike (1 pikë)
2. se autori këtë poezi e ka shkruar në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore (1 pikë)

*Gjithsej 2 pikë*

**Kërkesa 2.**

Nxënësi thekson:

1. se motivi qendror i poezisë është sakrifikimi i poetit përmes veprës poetike për të mirën e përgjithshme

*Gjithsej 1 pikë*

**Kërkesa 3.**

Nxënësi thekson:

1. se poeti përdor vargun tetërrokësh (1 pikë)
2. se poezia është e përbërë nga gjashtë strofa trevargëshe dhe një strofë katërvargëshe, të gjitha të rimuara (1 pikë)
3. se poezia rrëfehet në vetën e parë, si monolog (1 pikë)
4. se figurat mbizotëruese stilistike janë metafora dhe aliteracioni (1 pikë)

*Gjithsej 4 pikë*

**Kërkesa 4.**

Nxënësi thekson:

1. se kujt i drejtohet heroi lirik i kësaj poezie (1 pikë)
2. se Nositi simbolizon poetin (1 pikë)

3. se sakrifikimi bëhet nga dashuria për të tjerët(1 pikë)
4. se akti i krijimit përngjan me aktin e hapjes së gjirit të Nositit për t'i ushqyer zogjtë e vet me gjakun e tij (1 pikë)
5. për gjuhën e zjarrtë, plot me emocione që e përshkon poezinë (1pikë)
6. për atmosferën që mbizotëron në këtë poezi (1 pikë)

*Gjithsej 6 pikë*

**Kërkesa 5.**

Nxënësi thekson:

1. se vargu i parë dhe vargu i fundit janë të njëjtë dhe (nxënësi) shpreh mendimin e tij për efektin që krijon ky veprim i poetit

*Gjithsej 1 pikë*

**Kërkesa 6.**

Nxënësi:

1. vëren se poeti përdor figurën e personifikimit (shpirtëzimit) të liqenit

*Gjithsej 1 pikë*

**Kërkesa 7.**

Nxënësi:

2. gjatë hartimit të esesë përdor citate nga poezia dhe pastaj shpreh mendimet e veta për to.

*Gjithsej 1 pikë*

**VËREJTJE: Të gjitha kërkesat shumëzohen me 2, përveç kërkesës 1.**

**Gjuha dhe struktura e tekstit**

**Kërkesa 8.**

- **Leksiku**

  Vlerësohet:

1. origjinaliteti (interpreton me fjalë të veta, eseja nuk bazohet vetëm në parafrazime dhe përsëritje të formulimeve të dhëna), pasuria e gjuhës, shprehshmëria (1 pikë)
2. të shprehurit e qartë dhe të saktë, pa dykuptimësi, struktura e fjalisë me stil (1 pikë)

*Gjithsej 2 pikë*

**Kërkesa 9.**

- **Gramatika**

  Vlerësohet:

1. përdorimi i drejtë i rasave (1 pikë)
2. shkrimi i saktë i formave foljore, përdorimi i natyrshëm i sintaksës së shqipes (shmangia e përdorimit të ndërtimeve të huaja), zbatimi i rregullt i rregullave të kongruencës (përputhjes) (1 pikë)
3. dallimi semantik i parafjalëve për dhe mbi ose përemrit i vet/ i tij ose përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit lidhur me këtë, duke marrë parasysh ose përemrave që, i cili, e cila, të cilët etj. (1pikë)

***Gjithsej 3 pikë***

**Kërkesa 10.**

- **Drejtshkrimi**

  Vlerësohet:

1. shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, shkrimi i fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese (1 pikë)
2. zbatimi i njohurive për alternimet e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores ë, zbatimi i rregullave sipas së cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j (bukuria, dashuria etj), duke pasur parasysh disa përjashtime (Lirijes, Selvijes, Mihrijes, Hajrijes) (1pikë)
3. përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit (pika në fund të fjalisë, te shkurtesat, pikëpresja, pikëpyetja, pikëçuditja, presja (te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse...) (1 pikë)

***Gjithsej 3 pikë***

**Kërkesa 11.**

- **Lidhshmëria**

  Vlerësohet:

1. lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit ose paragrafëve (1 pikë)

***Gjithsej 1 pikë***

**Kërkesa 12.**

- **Struktura e tekstit**

1. teksti i strukturuar (hyrja, zhvillimi, përfundimi) ose ndarja e paragrafëve brenda esesë, sidomos në pjesën kryesore të esesë (1 pikë)

***Gjithsej 1 pikë***

# ESEJA 2:
# *”PLAKU DHE DETI”- Ernest Heminguej*

## Përmbajtja

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 1.** | Nxënësi thekson:<br>1. cilës letërsi i përket vepra letrare “Plaku dhe deti” (1 pikë)<br>**Gjithsej 1 pikë** |
| **Kërkesa 2.** | Nxënësi thekson:<br>1. formën letrare të kësaj vepre (1 pikë)<br>**1 pikë** |
| **Kërkesa3.** | Nxënësi thekson:<br>1. autorin e veprës si njërin nga shkrimtarët amerikanë më në zë të shekullit të kaluar e përfaqësues kryesor të “brezit të humbur” (1 pikë)<br>2. çmimin që ka marrë Heminguej për krijimtarinë që kulmoi me këtë kryevepër (1 pikë)<br>3. cila veti e personazhit (plakut) theksohet më shumë (1 pikë)<br>4. psikologjinë e plakut Santiago (1 pikë)<br>5. raportin e djaloshit Manolin me plakun Santiago, çka sheh ai te plaku (1 pikë)<br>6. teknikën shkrimore (formacionin stilistik-letrar) (1 pikë)<br>**Gjithsej 6 pikë** |
| **Kërkesa 4.** | Nxënësi thekson:<br>1. narratorin e veprës (1 pikë)<br>2. vendin e shtjellimit të ngjarjes në këtë vepër (1 pikë)<br>**Gjithsej 2 pikë** |
| **Kërkesa 5.** | Nxënësi thekson:<br>1. personazhet e tjera (1 pikë)<br>**Gjithsej 1 pikë** |
| **Kërkesa 6.** | Nxënësi thekson:<br>1. temën e veprës, simbolikën e peshkaqenëve (1 pikë)<br>2. gjuhën e veprës (1 pikë)<br>3. porosinë kryesore të veprës sipas mendimit të vet (1 pikë)<br>**Gjithsej 3 pikë** |
| **Kërkesa 7.** | Nxënësi:<br>1. shpreh përshtypjet e veta për luftën që zhvillon plaku me peshkaqenin dhe durimin që e karakterizon<br>**Gjithsej 1 pikë** |

**VËREJTJE: Të gjitha kërkesat shumëzohen me 2.**

## Gjuha dhe struktura e tekstit

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 8.**<br>**- Leksiku** | Vlerësohet:<br>1. të shprehurit e qartë dhe të saktë, pa dykuptimësi, struktura e fjalisë me stil (1 pikë)<br>**Gjithsej 1 pikë** |
| **Kërkesa 9.**<br>**- Gramatika** | Vlerësohet:<br>1. përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, (koha e kryer , koha e tashme, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), zbatimi i rregullt i rregullave të kongruencës (përputhjes (1 pikë)<br>*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*<br>2. 2. dallimi semantik i parafjalëve për dhe mbi, ose përemrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave që, i cili, e cila, të cilët etj. (1pikë)<br>*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*<br>**Gjithsej 2 pikë** |
| **Kërkesa 10.**<br>**- Drejtshkrimi** | Vlerësohet:<br>1. shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave dh/ll, ç/q, gj/xh, e/ë , shkrimi i saktë i numrave, shkrimi i fjalëve bashkë dhe ndaras, (1 pikë)<br>*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*<br>2. zbatimi i njohurive për alternimet e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores ë, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j (bukuria, dashuria etj), duke pasur parasysh disa përjashtime (Lirijes, Selvijes, Mihrijes, Hajrijes) (1pikë)<br>*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*<br>3. përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit (pika në fund të fjalisë, te shkurtesat, pikëpresja, pikëpyetja, pikëçuditja, presja (te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse...) (1 pikë)<br>*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*<br>**Gjithsej 3 pikë** |
| **Kërkesa 11.**<br>**- Lidhshmëria** | Vlerësohet:<br>1. lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit (1pikë)<br>**Gjithsej 1 pikë** |
| **Kërkesa 12.**<br>**- Struktura e tekstit** | 2. teksti i strukturuar (hyrja, shtjellimi, përfundimi) ose ndarja e paragrafëve brenda esesë, sidomos në pjesën e shtjellimit të esesë (1 pikë)<br>**Gjithsej 1 pikë** |

# ESEJA 3:
# *”HISTORIA E SKËNDERBEUT” - Marin Barleti*

**Përmbajtja**

**Kërkesa 1.**

Nxënësi thekson:

1. epokën letrare së cilës i takon “Historia e Skënderbeut”, burimin që paraqet kjo vepër për jetën e heroit tonë kombëtar (1 pikë)
2. idetë e Barletit në “Historinë e Skënderbeut” (1 pikë)
3. çështjen e lirisë dhe të drejtës që mbron populli shqiptar dhe Skënderbeu (1 pikë)

*Gjithsej 3 pikë*

**Kërkesa 2.**

Nxënësi thekson:

1. zotësinë oratorike të Skënderbeut (1 pikë)
2. trimërinë e Skënderbeut (1 pikë)
3. strategjinë ushtarake të Skënderbeut (1 pikë)
4. karakteristikat historiko-letrare të veprës (1 pikë)
5. gjuhën latine si gjuhë në të cilën është shkruar vepra (1 pikë)
6. figurat letrare në vepër (1 pikë)

*Gjithsej 6 pikë*

**Kërkesa 3.**

Nxënësi thekson:

1. stilin që përdor autori në këtë vepër (1 pikë)
2. narracionin e pasur (përshkrimet) në vepër (1 pikë)
3. frymën që e përshkon veprën (1 pikë)

*Gjithsej 3 pikë*

**Kërkesa 4.**

Nxënësi thekson:

1. rrethanat historike e letrare të kohës së realizimit të veprës së Barletit “Historia e Skënderbeut” (1 pikë)
2. shkruan për konceptin humanist për historinë që ndihet në “Historinë e Skënderbeut” (1 pikë)

3. shkruan për mesazhin që sjell autori përmes veprës "Historia e Skënderbeut" (1 pikë)

***Gjithsej 3 pikë***

**VËREJTJE: Të gjitha kërkesat shumëzohen me 2.**

**Gjuha dhe struktura e tekstit**

**Kërkesa 5.**

- **Leksiku**

Vlerësohet:

1. të shprehurit e qartë dhe të saktë, pa dykuptimësi, struktura e fjalisë me stil (1 pikë)

***Gjithsej 1 pikë***

**Kërkesa 6.**

- **Gramatika**

Vlerësohet:

1. përdorimi i drejtë i rasave , shkrimi i saktë i formave foljore, (koha e kryer, koha e tashme, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja) (1pikë)

   *(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

2. zbatimi i rregullt i rregullave të kongruencës (përputhjes), dallimi semantik i parafjalëve për dhe mbi, pastaj i përemrit i vet/i tij dhe përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit lidhur me këtë, duke marrë parasysh, si dhe i përemrave që, i cili, e cila, të cilët etj. (1pikë)

   *(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

***Gjithsej 2 pikë***

**Kërkesa 7.**

- **Drejtshkrimi**

Vlerësohet:

1. shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave dh/ll, ç/q, gj/xh, e/ë , shkrimi i saktë i numrave, shkrimi i fjalëve bashkë dhe ndaras (1 pikë)

   *(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

2. shkrimi i saktë i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimet e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores ë, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j (bukuria, dashuria etj), duke pasur parasysh disa përjashtime (Lirijes, Selvijes, Mihrijes, Hajrijes) (1pikë)

   *(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

3. përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit (pika në fund të fjalisë, te shkurtesat, pikëpresja, pikëpyetja, pikëçuditja, presja (te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse...) (1 pikë)

   *(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

***Gjithsej 3 pikë***

**Kërkesa 8.**

- **Lidhshmëria**

  Vlerësohet:

1. lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit (1pikë)

***Gjithsej 1 pikë***

**Kërkesa 9.**

- **Struktura e tekstit**

1. teksti i strukturuar (hyrja, shtjellimi, përfundimi), ndarja e paragrafëve brenda shtjellimit të esesë (1 pikë)

## ESEJA 4:
## ANALIZA E VEPRËS *„DUKE PRITUR GODONË ” - S. Beket*

**Përmbajtja**

**Kërkesa 1.**

Nxënësi thekson:

1. se kjo vepër është dramë e absurdit antidramë (1 pikë)
2. shkrimtarin/shkrimtarët e dramës së absurdit (p.sh. E. Jonesko, A. Adamov... (1 pikë)
3. karakteristikat e këtij lloji të dramës (p.sh. antidrama apo drama e absurdit ndryshon krejtësisht nga drama klasike, pra nuk ka kompozicion të zakonshëm të dramës dhe as konflikt; nuk ka ngjarje - as fillim, kohëzgjatje dhe as zhvillim; nuk ka unitet psikologjik të personazhit, personazhet janë antiheronj - nuk dihet se kush janë, nga janë, çka dëshirojnë... dhe përgjigje të ngjashme të sakta) (1 pikë)

***Gjithsej 3 pikë***

**Kërkesa 2.**

Nxënësi:

1. thekson se drama ka dy akte (1 pikë)
2. përshkruan pamjen e skenës, thekson ngjashmëritë dhe dallimet në strukturën e e akteve (p.sh. gjithçka ndodh në hapësirë të njëjtë, afër pemës – në aktin e parë pema është pa gjethe, në aktin e dytë pema ka gjethe ...dhe përgjigje të ngjashme të sakta (1 pikë)
3. e përshkruan Vladimirin - sjelljen e tij në skenë, si dhe gjërat e rëndësishme që kanë të bëjnë me të (p.sh. Vladimiri është më i kulturuar, më i arsimuar sesa Estragoni, i sqaron atij shumë kuptime...(1 pikë)
4. e përshkruan Estragonin – sjelljen e tij në skenë, si dhe gjërat e rëndësishme që kanë të bëjnë me të (p.sh. është më i vogël, më i dobët, më spontan se Vladimiri, i është nënshtruar vullnetarisht (1 pikë)

   **OSE:** nuk i përshkruan veçanërisht Vladimirin dhe Estragonin, por më tepër thekson sjelljen e tyre - p.sh. nuk janë të sigurt në të djeshmen dhe të sotmen, në kohë; shkrimtari thotë se janë Estragoni dhe Vladimiri, kurse ata paraqiten si Didi dhe Gogo, derisa Pocit dhe Likit i paraqiten si Katuli dhe Alberti; Vladimiri është rezonues i dramës, i cili thotë se koha kalon ngadalë dhe se shkurtohet me ngjarjet që në shikim të parë mund të duken të arsyeshme, derisa mos të bëhen shprehi; Estragoni është poet, i cili e pyet veten mos vallë nuk shihet se është poet duke treguar në kostumin e tij të vjetër dhe të shqyer; në episodin me Pocin dhe Likin sillen sikur shikojnë shfaqjen dhe provojnë të kuptojnë paraqitjen e tyre dhe marrëdhëniet në mes tyre...(2 pikë)

   **OSE:** nxënësi tregon për paqëndrueshmërinë njerëzore (në fillim Vladimiri dhe Estragoni dënojnë Pocon për sjelljen e tij ndaj Likit, e më pas ia kthejnë shpinën Likit, sepse gjoja ka sjellje të papërgjegjshme ndaj njeriut të mirë dhe zotërisë); përmes Vladimirit dhe Estragonit

   nxënësi vë theksin në kriteret e humbura, sjelljet e tyre joserioze në situata serioze, por edhe në vetëdijen për shpresën sepse ata, edhe pse Godo nuk vjen, edhe më tej presin...dhe përgjigje të ngjashme të sakta (2 pikë)
5. thekson sjelljen e Pocos dhe Likit (p.sh. Poco është pasanik, ai është zotëri dhe me shërbëtorin e vet Likin e drejton me ndihmën e litarit që i është i mbështjellë rreth qafës së Likit; Liki është i varfër dhe i përulur para padronit të tij dhe e dëgjon pa asnjë kundërshtim; në fund të antidramës mësohet se Liki është shurdhmemec, kurse Poco është verbuar (1 pikë)

6. thekson rolin e tyre në strukturën e dramës (p.sh. funksioni i episodit me Pocon dhe me Gëzimin (Likin) është që të krijohet iluzioni se prapëseprapë diçka do të ndodhë (1 pikë)
7. thekson vogëlushin që sjell lajmin nga Godoja dhe/ose komenton porosinë e tij se do të vijë të nesërmen (1 pikë)

*Gjithsej 7 pikë*

**Kërkesa 3.**

Nxënësi thekson:

1. rolin e gjuhës dhe mënyrën në të cilën flasin heronjtë (p.sh. gjuha është e reduktuar, dialogët janë të pakuptimtë, ka lojë me fjalë, mosmarrëveshje verbale, paqartësi, ka shumë gjeste, mimikë, lëvizje... dhe përgjigje të ngjashme të sakta) (1 pikë)
2. shtresën reale të dramës duke apostrofuar se ky është një tregim për dy endacakë të cilët në pamundësi që të vendosin se çka do të duhej të bëhet nuk bëjnë asgjë dhe përgjigje të ngjashme të sakta) (1 pikë)
3. shtresën metafizike të dramës (p.sh. nxënësit i kujtohen fjalët e Vladimirit që ata paraqesin njerëzimin dhe përgjigje të ngjashme të sakta) (1 pikë);

   **OSE:** nëse nuk i ndan shtresën reale dhe metafizike të dramës, por shkruan se Poco është njeri i fuqishëm me litar në dorë, Liki i pafat me litar rreth qafës dhe Vladimiri e Estragoni varfanjakë dhe përgjigje të ngjashme të sakta) (1 pikë)

*Gjithsej 3 pikë*

**Kërkesa 4.**

Nxënësi:

1. në formë të përfundimit sqaron titullin e veprës (p.sh. pritja e shpëtimit nga Zoti/ e lidh fjalën Godo me kuptimin e saj në gjuhën angleze/ të përmendurit e tregimeve biblike/Godo është gjithçka nga i cili pritet shpëtimi... dhe përgjigje të ngjashme të sakta) (1 pikë)
2. shpreh si e kupton ai vetë porosinë e dramës së Beketit – është me rëndësi të përmendet pritja e kotë (1 pikë)

*Gjithsej 2 pikë*

**VËREJTJE: Të gjitha kërkesat shumëzohen me 2.**

## Gjuha dhe struktura e tekstit

**Kërkesa 5.**

- **Leksiku**

Vlerësohet:

1. të shprehurit e qartë dhe të saktë, pa dykuptimësi, struktura e fjalisë me stil (1 pikë)

***Gjithsej 1 pikë***

**Kërkesa 6.**

- **Gramatika**

Vlerësohet:

1. përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, (koha e kryer , pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja) (1pikë)

   *(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

2. zbatimi i rregullt i rregullave të kongruencës (përputhjes), dallimi semantik i parafjalëve për dhe mbi, ose përemrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave që, i cili, e cila, të cilët etj. (1pikë)

   *(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

***Gjithsej 2 pikë***

**Kërkesa 7.**

- **Drejtshkrimi**

Vlerësohet:

1. shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave dh/ll, ç/q, gj/xh, e/ë , shkrimi i saktë i numrave, shkrimi i fjalëve bashkë dhe ndaras (1 pikë)

   *(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

2. shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimet e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores ë, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j (bukuria, dashuria etj), duke pasur parasysh disa përjashtime (Lirijes, Selvijes, Mihrijes, Hajrijes) (1pikë)

   *(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

3. përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit (pika në fund të fjalisë, te shkurtesat, pikëpresja, pikëpyetja, pikëçuditja, presja (te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse...) (1 pikë)

   *(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

***Gjithsej 3 pikë***

**Kërkesa 8.**

- **Lidhshmëria**

  Vlerësohet:

1. lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit (1pikë)

***Gjithsej 1 pikë***

**Kërkesa 9.**

- **Struktura e tekstit**

  Vlerësohet:

1. teksti i strukturuar (hyrja, shtjellimi, përfundimi), ndarja e paragrafëve brenda shtjellimit të esesë (1 pikë)

***Gjithsej 1 pikë***

## ESEJA 5:
## *”GJENERALI I USHTRISË SË VDEKUR” - Ismail Kadare*

**Përmbajtja**

**Kërkesa 1.**

Nxënësi thekson:

1. epokën letrare së cilës i takon “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, (d.m.th. letërsisë moderne ose bashkëkohore) (1 pikë)

***Gjithsej 1 pikë***

**Kërkesa 2.**

Nxënësi thekson:

1. idenë kryesore të autorit në veprën “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” dhe sintagmën ushtri e vdekur (1 pikë)

   *(Nxënësi merr 1 pikë, nëse thekson vetëm idenë kryesore të autorit në këtë vepër, kurse 2 pikë, nëse shpjegon sintagmën “ushtri e vdekur”)*

***Gjithsej 2 pikë***

**Kërkesa 3.**

Nxënësi thekson:

1. çfarë simbolizon abstraksioni i ushtrisë së vdekur (1 pikë)

***Gjithsej 1 pikë***

**Kërkesa 4.**

Nxënësi thekson:

1. lidhshmërinë e fabulës së këtij romani me ndonjë baladë popullore shqiptare, krijimin e portretit të shqiptarit liridashës, human dhe fisnik në vepër (1 pikë)

   *(Nxënësi merr 1 pikë, nëse thekson vetëm lidhshmërinë e fabulës së këtij romani me ndonjë baladë popullore shqiptare, kurse 2 pikë, nëse thekson edhe portretin e shqiptarit liridashës, human dhe fisnik në vepër)*

***Gjithsej 2 pikë***

**Kërkesa 5.**

Nxënësi thekson:

1. rolin e priftit dhe të gjeneralit (1 pikë)
2. ushtrinë e vdekur që zhvarroset dhe paketohet në thasë najloni (1 pikë)
3. paraqitjen e ndëshkimit moral të gjeneralit në raport me të kaluarën (1 pikë)

***Gjithsej 3 pikë***

**Kërkesa 6.**

Nxënësi thekson:

1. momentin e thyerjes së moralit të gjenerali në dasmën shqiptare (1 pikë)
2. plakën Nicë që mishëron humanizmin dhe heroizmin për lirinë (1 pikë)
3. rrethanat historike e letrare të veprës "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" (1 pikë)
4. se "lëvizja" e të vdekurve është përftesa groteske më e fuqishme (1 pikë)

***Gjithsej 4 pikë***

**Kërkesa 7.**

Nxënësi thekson:

1. se vepra rikrijon itinerarin e krimeve dhe të dështimeve të ushtrisë pushtuese (1 pikë)

2. gjuhën, figurat, stilin dhe teknikat e tjera të përdorura nga autori për të arritur efektet e caktuara artistike (1 pikë)

   *(Nxënësi merr 1 pikë, nëse thekson vetëm rikrijimin e itinerarit të krimeve dhe të dështimeve të ushtrisë pushtuese, kurse 2 pikë, nëse përmend edhe gjuhën që përdor autori i kësaj vepre, disa nga figurat, stilin dhe teknikat që ka përdorur Kadare për të arritur efekte të caktuara artistike.)*

***Gjithsej 2 pikë***

**VËREJTJE: Të gjitha kërkesat shumëzohen me 2.**

**Gjuha dhe struktura e tekstit**

**Kërkesa 8.**

- **Leksiku**

  Vlerësohet:

1. të shprehurit e qartë dhe të saktë, pa dykuptimësi, struktura e fjalisë me stil (1 pikë)

***Gjithsej 1 pikë***

**Kërkesa 9.**

- **Gramatika**

  Vlerësohet:

1. përdorimi i drejtë i rasave, dallimi semantik i parafjalëve për dhe mbi, ose përemrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave që, i cili, e cila, të cilët etj. (1 pikë)

*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

2. shkrimi i saktë i formave foljore, (koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja), zbatimi i rregullt i rregullave të kongruencës (përputhjes) (1 pikë)

*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

***Gjithsej 2 pikë***

**Kërkesa 10.**

- **Drejtshkrimi**

Vlerësohet:

1. shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave dh/ll, ç/q, gj/xh, e/ë , shkrimi i saktë i numrave, shkrimi i fjalëve bashkë dhe ndaras, shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit (1 pikë)

*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

2. zbatimi i njohurive për alternimet e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores ë, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j (bukuria, dashuria etj), duke pasur parasysh disa përjashtime (Lirijes, Selvijes, Mihrijes, Hajrijes) (1pikë)

*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

3. përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit (pika në fund të fjalisë, te shkurtesat, pikëpresja, pikëpyetja, pikëçuditja, presja (te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse...) (1 pikë)

*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*

................................................................................ ***Gjithsej 3 pikë***

**Kërkesa 11.**

- **Lidhshmëria**

Vlerësohet:

1. lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit (1pikë)

................................................................................ ***Gjithsej 1 pikë***

**Kërkesa 12.**

- **Struktura e tekstit**

Vlerësohet:

1. teksti i strukturuar (hyrja, shtjellimi, përfundimi) (1 pikë)

................................................................................ ***Gjithsej 1 pikë***

# ESEJA 6: TEMA E MARTESËS NË KOMEDINË "KATËRMBËDHJETË VJEÇ DHËNDËR" - A. Z. ÇAJUPI

## Përmbajtja

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 1.** | Nxënësi thekson se:<br>1. "Katërmbëdhjetë vjeç dhëndër" është një komedi, pra vepër e gjinisë dramatike (1 pikë)<br>**Gjithsej 1 pikë** |
| **Kërkesa 2.** | Nxënësi thekson se:<br>1. Çajupi është ndër themeluesit e komediografisë shqiptare (1 pikë)<br>2. tema kryesore e kësaj komedie është goditja e zakoneve të tejkaluara, siç ishte për shembull martesa e partnerëve të pabarabartë në moshë (1 pikë)<br>3. komedia është në vargje, me rimë (1 pikë)<br>**Gjithsej 3 pikë** |
| **Kërkesa 3.** | Nxënësi thekson se:<br>1. është shkruar me një gjuhë të gjallë, me humor të natyrshëm, spontan (1 pikë)<br>2. "Katërmbëdhjetë vjeç dhëndër" klasifikohet në grupin e komedive të zakoneve (1 pikë)<br>3. është shkruar me teknikën realiste (1 pikë)<br>4. aty trajtohen subjekte nga jeta aktuale e shoqërisë shqiptare (1 pikë)<br>**Gjithsej 4 pikë** |
| **Kërkesa 4.** | Nxënësi thekson se:<br>1. në komedi përshkruhet pozita e vështirë e femrës në shoqërinë shqiptare (1 pikë)<br>2. kryepersonazhi i komedisë, Tana, megjithëse edhe vetë viktimë e zakoneve patriarkale, përpiqet ta mbrojë dhe t'ia zgjasë jetën asaj mendësie (1 pikë)<br>3. martesa nuk u bë si kurorëzim i dashurisë së dy personave të pjekur apo që dashurohen, por si marrëveshje e prindërve, kryesisht për shkaqe interesi, që vjehrra të ketë një fuqi krahu më shumë në shtëpi (1 pikë)<br>4. Vangjeli ka tiparet e një burri tipik të asaj kohe, sidomos në pamjen kur e kërcënon bashkëshorten se edhe mund ta rrahë, sepse në raport me gratë është shqiptar i vërtetë i asaj kohe, kurse me miratimin e planeve të bashkëshortes shpreh pajtimin e vet me atë realitet (1 pikë)<br>**Gjithsej 4 pikë** |
| **Kërkesa 5.** | Nxënësi thekson se:<br>1. në komedi nuk ka një veprim të mirëfilltë dramatik, por përshkruhet me shumë humor njëmendësia e kapërcyer për kohën (1 pikë)<br>**Gjithsej 1 pikë** |

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 6.** | Nxënësi thekson se:<br>1. në komedi ka situata të frymëzuara nga poezia popullore dhe etnografia, siç janë pamja e dasmës dhe ngritja e dollive (1 pikë)<br>2. komedia e arrin kulmin në pamjen e fundit kur dhëndri 14 vjeçar, në natën e parë të martesës, i propozon nuses që të lozin bashkë, sepse e konsideron si motër, gjatë hartimit të esesë përdor citate nga komedia dhe pastaj shpreh mendimet e veta për to (1 pikë)<br>**Gjithsej 2 pikë** |

**VËREJTJE: Të gjitha kërkesat shumëzohen me 2.**

## Gjuha dhe struktura e tekstit

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 7.**<br>**- Leksiku** | Vlerësohet:<br>të shprehurit e qartë dhe të saktë, pa dykuptimësi, struktura e fjalisë me stil (1 pikë)<br>**Gjithsej 1 pikë** |
| **Kërkesa 8.**<br>**- Gramatika** | Vlerësohet:<br>1. përdorimi i drejtë i rasave, shkrimi i saktë i formave foljore, (koha e kryer, pjesorja, foljet pavetore, përcjellorja) (1pikë)<br>*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*<br>2. zbatimi i rregullt i rregullave të kongruencës (përputhjes), dallimi semantik i parafjalëve për dhe mbi, ose përemrit i vet/ i tij, përdorimi i drejtë i ndërtimeve të tipit lidhur me këtë, duke marrë parasysh dhe i përemrave që, i cili, e cila, të cilët etj. (1pikë)<br>*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*<br>**Gjithsej 2 pikë** |
| **Kërkesa 9.**<br>**- Drejtshkrimi** | Vlerësohet:<br>1. shkrimi i drejtë i shkronjës së madhe, përdorimi i drejtë i shkronjave r/rr, dh/ll, k/q, s/z, k/g, ç/q, gj/xh, e/ë, shkrimi i saktë i numrave, shkrimi i fjalëve bashkë dhe ndaras (1 pikë)<br>*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*<br>2. shkrimi i trajtës mohuese, apostrofit, zbatimi i njohurive për alternimet e zanoreve, përdorimi i drejtë i zanores ë, zbatimi i rregullave sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja j (bukuria, dashuria etj), duke pasur parasysh disa përjashtime (Lirijes, Selvijes, Mihrijes, Hajrijes) (1pikë)<br>*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*<br>3. përdorimi i drejtë i shenjave të pikësimit (pika në fund të fjalisë, te shkurtesat, pikëpresja, pikëpyetja, pikëçuditja, presja (te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse...) (1 pikë)<br>*(Në qoftë se nxënësi bën një gabim në këtë kërkesë, merr 0 pikë)*<br>**Gjithsej 3 pikë** |

| | |
|---|---|
| **Kërkesa 10.**<br>**- Lidhshmëria** | Vlerësohet:<br>1. lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit (1pikë)<br>**Gjithsej 1 pikë** |
| **Kërkesa 11.**<br>**- Struktura e tekstit** | Vlerësohet:<br>1. teksti i strukturuar (hyrja, shtjellimi, përfundimi) (1 pikë)<br>**Gjithsej 1 pikë** |

## ESEJA 7:
## REKLAMA – *ARSYEJA PËR TË (MOS) MENDUAR*

### Përmbajtja

**Kërkesa 1.**

Nxënësi tregon:

1. që afarizmi bashkëkohor bazohet në reklamë

***Gjithsej 1 pikë***

**Kërkesa 2.**

Nxënësi:

1. tregon se çfarë reklamohet (prodhimet, shërbimet…) (1 pikë)
2. sqaron se si bëhet reklama (përmes TV-së, radios, shtypit, bilbordeve, fllajerëve, tizerëve, mureve të ndërtesave…) (1 pikë)

***Gjithsej 2 pikë***

**Kërkesa 3.**

Nxënësi:

1. rrëfen se ai reklamat i përcjell në mënyrë mekanike apo mendon për to (1 pikë)
2. sqaron përse i përcjell reklamat, gjegjësisht, a mendon për to; ose përse nuk i përcjell reklamat, gjegjësisht përse nuk mendon për to; (1 pikë)

***Gjithsej 2 pikë***

**Kërkesa 4.**

Nxënësi:

